



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.159

7 dhjetor

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.675, datë 6.7.2011	Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit, 2011-2015, dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj..... 7569
Udhëzim i MASH nr.39, datë 6.10.2011	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master shkencor/master i arteve të bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012..... 7603
Udhëzim i MASH nr.41, datë 13.10.2011	Për procedurën e konkurrimit me formularin A3 dhe regjistrimin e kandidatëve fitues në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2011-2012..... 7605
Udhëzim i MASH nr.42, datë 13.10.2011	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.39, datë 6.10.2011 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/ “Master i arteve të bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012”..... 7609
Udhëzim i MASH nr.44, datë 3.11.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”..... 7610
Urdhër i MASH nr.511, datë 13.10.2011	Për rishpërndarjen e kuotave të përcaktuara në fazën e dytë të konkurrimit me formularin A2, të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012, nëpërmjet formularit A3..... 7611
Urdhër i MASH dhe MF nr.528, datë 25.10.2011	Për tarifën e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2011-2012..... 7616

VENDIM
Nr.675, datë 6.7.2011

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR
TERRORIZMIT, 2011-2015, DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit, 2011-2015, dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, të përmendura në tekstin e planit të veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT**

2011 - 2015

Hyrje

Përgatitja e strategjisë kundër terrorizmit mbetet një detyrim, ndaj të cilit vendi ynë mbështetet në prioritetet e përcaktuara për të luftuar terrorizmin me të gjitha format e shfaqjes së tij, nga nevoja e implementimit të objektivave që dalin nga detyrimet ndërkombëtare të miratuara nga K.S. të OKB-së, dokumenteve strategjike euro-atlantike etj., si dhe nga nevoja për të harmonizuar e koordinuar më mirë masat operacionale ndërmjet institucioneve shtetërore, ashtu edhe me partnerët dhe aleatët strategjikë.

Ky dokument, me shtrirje kohore 2011–2015, synon të arrijë:

- të identifikojë gjerësisht fenomenin e krimit të terrorizmit dhe fenomenet e tjera që rrjedhin prej tij, duke analizuar shkaqet e faktorët e tij;
- të evidentojë dhe dokumentojë veprimtarinë institucionale të të gjithë aktorëve që marrin detyrime për luftën kundër krimit të terrorizmit;
- të përcaktojë situatën aktuale ku ndodhet vendi ynë dhe masat për ndjekjen, parandalimin, mbrojtjen dhe reagimin ndaj këtij fenomeni;
- të shpallë objektivat për zbulimin dhe parandalimin e terrorizmit, si dhe masat për realizimin e tyre;
- të planifikojë e tregojë rrugët e implementimit të strategjisë;
- të evidentojë nevojat financiare apo burimet e mundshme financiare për realizimin e detyrimeve në funksion të implementimit të kësaj strategjie.

Ngjarjet e kohëve të fundit kanë dëshmuar se të gjitha shtetet europiane mbeten të ekspozuara ndaj kërcënimit të terrorizmit dhe ekstremizmit, si nga kërcënimet që vijnë nga brenda vendit ashtu edhe nga ato që vijnë nga jashtë. Republika e Shqipërisë nuk bën përjashtim në këtë drejtim. Megjithatë vendi ynë nuk ka përjetuar një fushatë të vazhdueshme terrori, ka elementë brenda shoqërisë që përpiqen të shfrytëzojnë njerëzit e pambrojtur për arritjen e objektivave të tyre ekstremiste. Megjithatë këto incidente të shfrytëzimit të situatës janë kontrolluar në mënyrë efektive në të shkuarën, ekzistojnë mundësitë që në të ardhmen mund të rishfaqen incidente të tilla, të cilat



do të kenë ndikim mbi sigurinë dhe unitetin brenda komuniteteve tona. Jo vetëm individët janë të ekspozuar, por shumica e fushave të shoqërisë sonë mund të jenë të ekspozuara për t'u shfrytëzuar nga terroristët, sidomos sektori financiar dhe industria e turizmit që po zhvillohet.

Dokumenti i propozuar do të mbështetet në strategjinë europiane, që bazohet në katër drejtime të punës: parandalimi, mbrojtja, ndjekja dhe reagimi. Kjo strategji reflekton shumë prej këtyre karakteristikave strategjike europiane, ndërkohë që mbetet me rëndësi shumë të madhe për nevojat e sigurisë së vendit tonë.

Shqipëria mbetet një vend paqësor dhe pluralist, ku njerëzit janë të lirë të ndjekin çdo besim fetar sipas zgjedhjes së tyre.

Prioritetet dhe detyrimet e këtij dokumenti janë në përputhje me objektivat e përcaktuar në dokumentet ekzistuese:

- Plani kombëtar i luftës kundër terrorizmit 2002;
- Dy urdhra të Kryeministrit të vitit 2003;
- Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit 2008, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.1140, datë 30.7.2008, të ndryshuar;
- Strategjia e menaxhimit të integruar të kufijve 2007-2013, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.668, datë 29.9.2007;
- Strategjia sektoriale e rendit publik 2007-2013, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.14, datë 9.1.2008.
- Vendimi i Komitetit Ndërinstitucional për masat kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit nr.1, datë 5.2.2010 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional për masat kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit".

Dokumente, nismave, traktateve ndërkombëtare etj. të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

KREU I

1.1 Situata e rrezikut të terrorizmit dhe ekstremizmit në Shqipëri

Fenomeni i terrorizmit në Shqipëri kërkon një analizë të veçantë dhe të gjerë, mbështetur në fakte e ngjarje konkrete për të përcaktuar format e shfaqjes së tij.

Zhvillimet ndërkombëtare, kanë krijuar një mjedis të ri politik dhe social-ekonomik, duke ndikuar dhe në ndryshimet e politikave të sigurisë. Rreziqet asimetrike vendosin sfidat më të reja për forcat e sigurisë kombëtare dhe publike, që përballen me kërcënime serioze, siç janë terrorizmi kombëtar, rajonal dhe ai ndërkombëtar.

Politikat e mbrojtjes dhe të sigurisë e kanë konsideruar terrorizmin si një nga sfidat kryesore dhe rreziqet për sigurinë kombëtare.

Pozicioni gjeostrategjik i Shqipërisë krijon kushte që vendi të synohet si një pikë tranzitimi, jo vetëm i trafikeve dhe i aktiviteteve të paligjshme, por edhe për përhapjen e sindromës së terrorizmit, veçanërisht atij me baza fundamentaliste shqiptare. Religjioni tek ne materializon karakteristikat e njohura historike. Megjithatë, përbërja fetare e popullsisë shqiptare, me një dominim mysliman, mund të synohet të përdoret si faktor për të shtrirë influencën në rajon, por dhe për të krijuar alibitë e zhvendosur vëmendjen nga elemente të tjera që operojnë në këtë fushë. Ky rast, mbetet shqetësim kryesor për ecurinë e marrëdhënieve të brendshme në vendet e rajonit, marrëdhëniet mes tyre, si dhe marrëdhëniet e rajonit me vendet dhe institucionet e hapësirës euro-atlantike dhe më gjerë.

Duke sjellë në vëmendje përfundimet e konflikteve në Ballkan, veçanërisht ndryshimet territoriale dhe hapësirat e banuara nga shqiptarët, të cilat për nga rëndësia janë madhore, mund të ndikojnë në ndryshimin e balancave tradicionale në rajon dhe aktivizimin e fenomeneve që lidhen

me terrorizmin. Duhet theksuar fakti se në trajtimin e aspekteve të këtij karakteri dhe veçanërisht kur ndodhin akte kriminale, në të cilën gjenden të përfshirë edhe elemente shqiptare, ky faktor konsiderohet një i tërë, duke mos bërë dallim së cilës pjesë të trojeve etnike i përket.

Me gjithë masat e marra e të aplikuara në mënyrë permanente, kërkohet rritje e nivelit cilësor të dokumenteve që të shprehin e garantojnë sigurinë. Është e pranueshme se në shoqërinë tonë nuk është arritur të vlerësohet gjerësia dhe ndërlikimet e kërcënimit terrorist. Një nga arsyet është se vendi ynë nuk është përballur me kërcënime serioze të nivelit strategjik, çka do e detyronte të përballej me masa më efikase.

Vendi ynë nuk është prekur nga sindroma e terrorizmit.

Disa nga faktorët që ndikuan në zhvillimin (përhapjen) gradual të fenomenit të ekstremizmit/terrorizmit në Shqipëri janë:

- Institucionalizimi i besimit fetar krijoi terren të favorshëm për futjen në Shqipëri të personave të pakontrolluar dhe ekstremistë, kryesisht nga vendet arabe, të cilët nën petkun fetar ndikuan në përhapjen e rrymave të ndryshme ekstreme;

- Ndërgjegjësimi i pakët i komunitetit për rrezikshmërinë dhe pasojat e terrorizmit dhe ekstremizmit;

- Niveli i ulët ekonomik, veçanërisht në shtresa të caktuara që shërbyen si ambiente për përhapjen dhe përfaqimin e fenomeneve ekstreme;

- Pozicioni gjeografik-strategjik i vendit tonë, i vendosur në udhëkryqet midis lindjes e perëndimit;

- Nivel i ulët i reagimit të institucioneve të shtetit, për të vlerësuar e parandaluar lindjen e fenomenit të ekstremizmit në Shqipëri;

- Mungesa e kuadrit të plotë ligjor, strukturor dhe infrastrukturës së nevojshme për të luftuar me cilësi këto fenomene;

- Mungesa e eksperiencës dhe e bashkëpunimit me partnerët dhe aleatët për të siguruar ekspertizën e nevojshme në këtë fushë.

Zhvillimet e ndodhura në rajonin e Ballkanit krahas problemeve të tjera, nxorën në pah fenomenin e nacionalizmit tradicional. Ky fenomen gjeti shtrat të favorshëm për shkaqe të anarkisë në rajon dhe përqendrimin të armatimit ushtarak në mënyrë të pakontrolluar nga individë apo grupe irredentiste që shfrytëzuan kontrabandën e armëve mes kufijve të rajonit tonë.

Ky fakt ka bërë që këto fenomene të reflektojnë probleme si brenda kufijve tanë, ashtu edhe në shtetet e tjera të rajonit, që ka reflektuar edhe me akte kriminale terroriste që kanë sjellë pasoja.

Pas ngjarjeve të 11-shtatorit në SHBA, në vendin tonë janë evidentuar raste që iniciojnë probleme të lidhura me ekstremizmin, si:

- Evidentimin e organizatave, financimeve, shoqatave dhe strukturave të ngritura në vendin tonë, mekanizmin e tyre funksional, disa mënyra financimi donatorësh, rrugët e realizimit të tyre, si dhe kodifikimet e bëra;

- Individë të dyshimtë dhe aktivë, si lidhje të Xhihadit dhe udhëheqësit të tyre shpirtëror Bin Laden, për të cilët kemi vepruar për interesat tona dhe për ata me aktivitet jashtë Shqipërisë duke bashkëpunuar me shërbimet partnere;

- Persona të dyshimtë (shtetas shqiptarë dhe të huaj), që krahas leksioneve teologjike janë trajnuar edhe nëpër kampe fushimi, si luftëtarë të Xhihadit Islamik apo siç emërtohen ndryshe “trupa të gatshme” që kanë shtrirje në të gjithë Europën;

- Investigimet për pasuritë që kanë shtetasit e huaj në vendin tonë, të cilat mund të rrjedhin nga burime të dyshimta apo organizata terroriste.

Për vitin 2006-2008, janë arrestuar dhe çuar në gjykim disa organizata kriminale, të cilat në përmbajtjen e tyre kriminale kanë përgatitur dhe kryer edhe akte të mpërhta kriminale të cilësuar “terroriste”.



1.2 Masa të marra për luftën kundër krimit të terrorizmit

Në kuadër të masave të luftës kundër terrorizmit, pas daljes së rezolutës nr.1267 të datës 15 tetor 1999, të Komitetit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe pas adoptimit të saj dhe miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, janë kryer disa veprime sekuestrimi të pasurive të personave të dyshuar si financues të terrorizmit, janë kryer sekuestrimet, pasuritë (llogaritë, investimet dhe asetet) e disa shtetasve të huaj të dyshuar për financim të terrorizmit.

Në mbështetje të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për luftën kundër financimit të terrorizmit” viti 1999, e ratifikuar me ligjin nr.8865, datë 14.3.2002; të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, janë kryer sekuestrimet e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet):

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të shtetasit Arab Asin Al-Qadi.

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të Fondacionit “Ringjallja e Trashëgimisë Islame” (Revival Of Islamic Heritage Society-RIHS).

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të fondacionit “Al Haramania”.

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të fondacionit “Taibah Internacional”, i njohur dhe si “Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave”.

- Për sekuestrimin e pasurive, llogaritë, investimet dhe asetet e shtetasit Abdul Latif Saleh.

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari të shtetasit Nabil Abdyl Sayadi.

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të Fondacionit “Global Relief Foundation” (GRF).

Lufta kundër organizatave kriminale e bandave të armatosura

Grupet kriminale shqiptare, veçanërisht disa prej tyre u përfshinë në trafikun e armëve, brenda dhe jashtë vendit, sidomos pas ngjarjeve të vitit 1997, duke u bërë pjesë e rrjeteve të këtij trafiku. Krahas këtij aktiviteti fitimprurës, u grumbulluan dhe u shpërndanë armë të ndryshme, duke i shoqëruar edhe me kryerje aktesh të mprehta kriminale me lëndë shpërthyesë, të cilat në thelb goditën rëndë sigurinë publike.

Lufta kundër terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit

Pozita e përshtatshme gjeografike e vendit tonë ka ndikim në fenomenin e terrorizmit. Grupet kriminale të përfshira në trafikimin e lëndëve narkotike, të armëve apo çdo lloj trafiku kriminal do ta përdorin territorin shqiptar si vend transit jo vetëm për kalimin e produkteve të drogës etj., por edhe për kalimin e armëve të shkatërrimit në masë, apo emisarëve të cilët qarkullojnë të veshur me petkun fetar, nacionalist etj.

Nga ana tjetër, mungesa e stabilitetit në rajonin e Europës Juglindore vazhdon të përbëjë një kërcënim për interesat shqiptare. Konfliktet, të ngrira ose të një natyre tjetër, që bazohen tek grupet etnike, besimet fetare dhe kombësia, vazhdojnë të jenë të pranishme brenda rajonit. Si rrjedhim, brenda rajonit janë shfaqur një numër grupesh nacionaliste, që pretendojnë se përfaqësojnë grupe minoritetesh, në bazë të trashëgimisë ose besimit të tyre të përbashkët.

Edhe ngjarjet e kohëve të fundit në disa zona të rajonit tonë, kanë demonstruar se këto konflikte politike mund të përshkallëzohen me shpejtësi të madhe, duke shkaktuar mungesë

stabiliteti, armiqësi të përhapura në shkallë të gjerë, si dhe migrimin e refugjatëve. Këto probleme që janë bërë tepër shqetësuese, vazhdojnë të monitorohen edhe nga organizmat ndërkombëtarë.

Nga këto zhvillime, gjykohet se një përshkallëzim i një ose më shumë konflikteve rajonale, do të ketë një ndikim të mundshëm mbi sigurinë e vendit tonë dhe mund të çojë në një rritje të ekstremizmit dhe radikalizmit në radhët e disa prej elementëve të pambrojtur ose me prirje të tilla në radhët e komunitetit tonë.

Vala aktuale e terrorizmit ndërkombëtar paraqitet me e ndjeshme në vendet e Lindjes së Mesme, Afrikës Veriore, pjesës nënkontinentale të Indisë dhe në mënyrë sporadike në rajonin e Ballkanit.

Përsa i përket kërcënimit, orientimi i politikës së jashtme të Shqipërisë nga perëndimi (SHBA/NATO) mund të shkaktojë armiqësi të jashtme ose të brendshme, të cilat mund të kenë ndikim negativ mbi sigurinë e saj kombëtare. Rreziku ndaj interesave shqiptare brenda vendit mund të gjykohet si i ulët; sidoqoftë, rreziku ndaj disa prej interesave të caktuara të huaja brenda vendit, tregtare ose diplomatike, mund të gjykohet si më i lartë se sa niveli i përgjithshëm i kërcënimit.

Toleranca dhe pluralizmi fetar vërehen në mbarë shoqërinë shqiptare; sidoqoftë, janë evidentuar një numër i vogël incidentesh lokale të konflikteve fetare, ndaj të cilëve kërkohet vëmendje e veçantë dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Janë evidentuar disa raste sporadike të akteve terroriste, si:

- Akt terrorist me origjinë të brendshme, i kryer në vitin 1995, në supermarketin VEFA, në Tiranë, ku humbën jetën disa persona dhe pati dëme të konsiderueshme materiale. Nga hetimi dhe gjykimi i çështjes rezultoi se akti terrorist ishte me origjinë të brendshme, ishte kryer nga pjesëtarë të organizatës kriminale “Hakmarrja për drejtësi”, të cilët janë gjykuar dhe dënuar.

- Në vitin 2007 është regjistruar një incident në bordin e avionit “Boeing 737”, i kompanisë “Turkish Airlines”, që udhëtonte nga Shqipëria për në Stamboll. Autori i krimit me shtetësi dhe kombësi turke, me punë në Tiranë, i cili udhëtonte në këtë avion, kërcënoi se do të kryente akt terrorist.

- Në tetor të vitit 2009 është arrestuar një shtetas shqiptar, me prirje ekstremiste islamike, për kryerjen e veprës penale “Stërvitje për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”, parashikuar nga KP, neni 232. Aktivitetin e tij kriminal ai e zhvillonte nëpërmjet faqeve të internetit. Kjo çështje ka karakter të brendshëm, por dyshohet se ka nxitje nga jashtë.

- Aktterrorist me origjinë të jashtme në bashkëpunim me shtetas shqiptarë, i kryer në vitin 1994, në postën kufitare të fshatit Peshkëpi – Gjirokastrë. Pjesëtarë të organizatës terroriste greke “MAVI” (rreth 12 veta), u futën në tokën shqiptare, në befasi rrethuan repartin ushtarak, vranë dy oficerë, plagosen disa ushtarë, rrëmbyen dy prej tyre dhe gjithë armatimin dhe u larguan në tokën greke të pashqetësuar. Me gjithë hetimet e bëra, pala greke nuk ofroi zgjidhje dhe bashkëpunim të mjaftueshëm.

- Plan për goditjen e ambasadës amerikane nga operativë të Xhihadit Islamik Egjiptian në vitin 1999.

- Kapja e celulës së Xhihadit Islamik Egjiptian (viti 1998), ku pesë operativë të celulës së këtij grupimi xhihadist penetruan në disa shoqata arabe me aktivitet në Shqipëri si EAMY, RTI, IIRO, Al-Haramain.

1.3 Përcaktimi i krimit të terrorizmit sipas legjislacionit shqiptar dhe format e shfaqjes së tij

Në legjislacionin shqiptar, përkatësisht në nenin 28 të Kodit Penal, jepet ky përcaktim për organizatat kriminale:

1. Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale.



Organizata kriminale, për realizimin e qëllimeve të saj, përdor forcën, mjetet e tjera të kërcënimit, nënshtrimit dhe heshtjen për shkak të pjesëmarrjes dhe veprimtarisë së saj, për të kryer vepra penale, për të siguruar, në çdo mënyrë, administrimin ose vënien nën kontroll të veprimtarisë ekonomike, të koncesioneve, autorizimeve, sipërmarrjeve dhe shërbimeve publike, për të realizuar përfitime ose avantazhe të padrejta për vetë a personat e tjerë.

2. Organizata terroriste është formë e veçantë e organizatës kriminale, që synon kryerjen e veprimeve të dhunshme për qëllime terroriste, si përmbysje të rendit kushtetues, turbullim të rëndë të rendit publik, ngjallje të frikës dhe pasigurisë në masë.

3. Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale, të parashikuara në krerët V, VI dhe VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi.

4. Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale.

5. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta.

6. Anëtarët e organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale, të kryera prej tyre, në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale.

7. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtim nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë, që gjykohej vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejtë ose prej tyre, si edhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuar kriminale.

Në vitin 2008 u ndryshua neni 230 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë duke u shprehur më qartë për vlerësimin dhe sanksionet ndaj organizimeve dhe fenomeneve që lidhen me terrorizmin.

KREU II

2.1 Aspekte institucionale dhe ligjore

Republika e Shqipërisë ka përshtatur kuadrin ligjor për luftën kundër terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e “Vendimit kuadër të Këshillit (të Europës) mbi luftën kundër terrorizmit”, Luksemburg, 13.6.2002, i cili kërkon që përcaktimi i krimeve terroriste të përafrohet në të gjitha shtetet anëtare, duke përfshirë ato krime që lidhen me gupe terroriste.

Kodi Penal, i miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, të ndryshuar, janë shtuar dispozita dhe sanksione, me qëllim dënimin e autorëve të akteve terroriste dhe përkrahësve të tyre. Ndryshimet në Kodin Penal janë si më poshtë:

- Në ligjin nr.9086, datë 19.6.2003 “Për një ndryshim në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, është shtuar neni 230/a - “Financimi i terrorizmit”. Financimi i terrorizmit ose mbështetja në çdo formë e tij dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm dhe me gjobë nga 5 milionë lekë deri në 10 milionë lekë (37.862 Euro-75.723 Euro).

- Në ligjin nr.9275, datë 16.9.2004 “Për një ndryshim në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është ndryshuar neni 28, në të cilin parashikohen format e veçanta të bashkëpunimit të pjesëtarëve në organizata kriminale dhe terroriste.

- Në ligjin nr.9686, datë 26.2.2007 “Për një ndryshim në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, janë bërë ndryshimet e nevojshme.

“Strategjia e sigurisë kombëtare e Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr.9322, datë 25.11.2004, përfaqëson tërësinë e mjeteve dhe instrumenteve shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga kërcënimet dhe rreziqet e jashtme e të brendshme.

“Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe terrorizmit”, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.1140, datë 30.7.2008, të ndryshuar, si dhe plani i veprimit, për zbatimin e kësaj strategjie.

Dokumenti strategjik kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”, i cili është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1077, datë 27.10.2009.

Ligji nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. Këto ligje janë në përputhje me kërkesat e rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Zbatimi i këtij ligji bëhet nga DPPPP (FIU), ndërsa administrimi i llogarive dhe asetëve të ngrira/sekuestruara/konfiskuara bëhet nga AAPSK.

Ligji nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, rregullon parandalimin e pastrimit të parave dhe të produkteve që burojnë nga vepra penale, parashikon rregullat dhe procedurat e raportimit tek strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji, si dhe kompetencat e tyre.

Ligji nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimin, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, zbatohen edhe për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indice, edhe për pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura.

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.44, datë 10.6.2009 “Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit””. Qëllimi i tij është parandalimi i përdorimit të subjekteve të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008, të cilët licencohen dhe/ose mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë për pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.140, datë 13.2.2008 “Për mënyrën e administrimit të pasurive të paluajtshme të sekuestruara, në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit”.

Rekomandimi i vendimit kuadër i KE-së, neni 5, dënimet - “Masat e ndëshkimit dhe dënimit të terroristëve”, apo të nenit 2 të tij, për krimet e lidhura me grupet terroriste.

Me ligjin nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda”, u krijua Gjykata për Krime të Rënda, dhe Prokuroria për Krimet e Rënda, e cila ka në kompetencë edhe hetimin e veprave penale në fushën kundër terrorizmit.

Ligji nr.10 173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

Ligji nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, punësimit, trajtimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë.

Ligji nr.10 193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.

2.2 Angazhimet përkatëse të institucioneve

Ministria e Brendshme

Me urdhër nr.372, datë 8.6.2009 të Ministrit të Brendshëm “Për krijimin e strukturave dhe limiteve organike në Policinë e Shtetit”, në luftën kundër terrorizmit janë të përfshira strukturat e mëposhtme:

- Departamenti për Hetimin e Krimeve.



- Drejtoria kundër Krimeve të Rënda/sektori kundër akteve terroriste/seksionet kundër akteve terroriste në 12 drejtoritë e Policisë në qarqe/sektori i mbështetjes tekniko shkencore dhe mbikëqyrjes.

- Drejtoria kundër Krimit Financiar/sektori kundër pastrimit të parave/sektori kundër krimeve kompjuterike/sektori për hetimin e aseteve kriminale/seksionet kundër pastrimit të parave, në 12 drejtoritë e policisë në qarqe.

Kryejnë veprime procedurale:

- Strukturat e Prokurorisë për Krime të Rënda;

- Strukturat e hetimit të krimit financiar në Prokurorinë e Rretheve Gjyqësore dhe 6 njësitë e përbashkëta hetimore kundër korrupsionit dhe krimit financiar në Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë e Gjirokastrë, krijuar me memorandum të përbashkët ndërinstitutional në vitet 2007 dhe 2009.

Kryejnë veprime investigative dhe procedurale:

- Sektori kundër pastrimit të parave në Drejtorinë kundër Krimit Financiar pranë Departamentit për Hetimin e Krimeve në Policinë e Shtetit.

- Sektori kundër krimeve kompjuterike në Drejtorinë kundër Krimit Financiar pranë Departamentit për Hetimin e Krimeve.

- Sektori kundër akteve terroriste në Drejtorinë kundër Krimeve të Rënda Departamenti për Hetimin e Krimeve në Policinë e Shtetit.

- Drejtoria Antiterror në Shërbimin Informativ të Shtetit.

- Departamenti i Rendit dhe Sigurisë Publike (DRSP):

Strukturat operacionale në luftën kundër terrorizmit janë të organizuara me ligjin nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Veprimtaria e tyre rregullohet me “Rregulloren e funksionimit të Strukturave operacionale”, miratuar me urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 1891, datë 7.12.2007. Repartet dhe njësitë speciale janë: reparti special “RENEA”/repartet e ndërhyrjes së shpejtë/reparti i helikopterëve/njësia antiexploziv/njësia e negocimit.

- Departamenti i Kufirit dhe Migracionit (DKM):

Departamenti i Kufirit dhe Migracionit i organizuara në nivel qendror dhe në nivel rajonal në 8 drejtori rajonale të kufirit e migracionit, në përbërje të të cilave janë 36 stacione policie, të cilat kanë kompetenca dhe ushtrojnë detyra në fushën e parandalimit dhe luftës kundër akteve terroriste.

Garda e Republikës

Garda e Republikës, e krijuar me ligjin nr.8869, datë 22.5.2003, ndryshuar, ka mision ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve të larta shtetërore, si dhe ato të huaja.

Prokuroria e Përgjithshme

Institucioni i Prokurorisë është i përfshirë në luftën kundër terrorizmit. Ajo ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Gjithashtu në Prokurorinë e Përgjithshme funksionon edhe Zyra e Përgjimeve dhe Telekomunikimeve. Me memorandum të përbashkët ndërinstitutional, funksionojnë strukturat e hetimit të krimit financiar, në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe 7 njësitë e përbashkëta hetimore, ngritur në Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë e Gjirokastrë.

Ministria e Financave

Strukturat e saj:

DPPPP (Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave) shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave të financimit të terrorizmit.

DPD (Drejtoria e përgjithshme e doganave) bashkëvepron me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të realizimit të misionit të saj për garantimin e sigurisë dhe të rendit publik në porte dhe aeroporte, duke përfshirë dhe masat në kuadër të luftës kundër terrorizmit.

AAPSK (Agjencia e Administrimit të Aseteve Kriminale) për administrimin e fondeve dhe të pasurive të sekuestruara e konfiskuara.

DPT (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) bën identifikimin e rasteve të pastrimit të parave, si dhe krimeve në fushën ekonomike.

Banka e Shqipërisë

- Banka e Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të funksioneve si autoritet mbikëqyrës, të kontrollojë zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet strukturave të saj, siguron bashkëpunimin e nevojshëm mes Prokurorisë, Interpolit dhe autoriteteve të huaja të drejtësisë në çështje që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar apo kundër terrorizmit dhe financimit të tij, në zbatim të ligjit nr.10/193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.

SHISH

Shërbimi Informativ Shtetëror, i krijuar me ligjin nr.8391, datë 28.10.1998, mbledh informacion nga jashtë në funksion të sigurimit kombëtar, kryen veprimtari kundërzbulimi për ruajtjen e integritetit, të pavarësisë e të rendit kushtetues, mbledh informacion për terrorizmin, për prodhimin dhe trafikun e narkotikëve, për prodhimin e armëve të dëmtimit në masë, për krimet kundër mjedisit, mbledh informacion për krimin e organizuar, krime që cenojnë sigurinë kombëtare.

Ministria e Mbrojtjes

- Shërbimi Informativ i Ushtrisë, krijuar e rregulluar me ligjin nr.9074, datë 29.5.2003 “Për Shërbimin Informativ Ushtarak”, ku përcakton mënyrat e marrjes, administrimit dhe shpërndarjes së informacionit të klasifikuar kundër terrorizmit.

- Komanda e Forcave Tokësore siguron veprimet operacionale në rast të incidenteve të ndodhura.

Ministria e Jashtme

Ministria e Jashtme, nëpërmjet strukturave të saj, siguron koordinimin dhe bashkëpunimin në planin rajonal e ndërkombëtar, duke shprehur angazhimin e vendit tonë në instrumentet ndërkombëtare të luftës kundër terrorizmit.

2.3 Kuadri institucional ekzistues

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave janë përgjegjëse këto struktura:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), e cila është në rolin e njësisë së inteligjencës financiare.

b) Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP). Ky komitet drejtohet nga Kryeministri dhe në përbërje ka Ministrin e Financave, Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Drejtorin e SHISH-it dhe Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKP-së.

c) Drejtoria e Krimeve Ekonomiko-Financiare dhe Drejtoria e Luftës kundër Krimit të Organizuar pranë Departamentit të Hetimit Kriminal, në Ministrinë e Brendshme.

Ruajtja e kufirit shtetëror

Institucionalisht Policia Kufitare dhe e Migracionit ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të kufirit, kontrollin e qarkullimit të njerëzve, mjeteve dhe mallrave nëpërmjet kufirit shtetëror.



Mbrojtja e bashkëpunëtorëve

Për të luftuar terrorizmin, kërkohet marrja e masave për mbrojtjen e dëshmitarëve e bashkëpunëtorëve të drejtësisë, me synim zbatimin e akteve ligjore përkatëse dhe çuarjen deri në fund të hetimeve kundër grupeve terroriste.

KREU III

Vizioni

Qëllimi strategjik afatgjatë i implementimit të kësaj strategjie është “të zvogëlojë në maksimum rrezikun ndaj terrorizmit që lidhet me vendin dhe interesat tona, duke siguruar përmirësimin e elementeve të sigurisë dhe rritjen e besimit të komunitetit për masat parandaluese ndaj akteve dhe fenomeneve terroriste”.

Theksi për arritjen e këtij qëllimi do të vihet në ndërprerjen e akteve terroriste përpara se ato të kryhen, duke përdorur një përgjigje të koordinuar nga shteti në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin. Çdo reagim duhet patjetër të marrë në konsideratë faktin se një sulm terrorist mund të jetë i suksesshëm nëse hartohen planet e emergjencave në përputhje me këto rreze.

Për të arritur këtë objektiv, do të jetë e nevojshme që të pakësohet rreziku i dëmit nga aktet terroriste dhe ekstremiste:

a) Duke zvogëluar kërcënimin ndaj vendit, nëpërmjet parandalimit të shkaqeve që janë burim i zhvillimit të terrorizmit dhe duke i ndjekur penalisht nëpërmjet proceseve gjyqësore personat e përfshirë në terrorizëm.

Mbetet detyrë e institucioneve përkatëse të parashikojnë masa konkrete ligjore, normative apo administrative për të mundësuar vlerësimin dhe ndjekjen e çdo sinjali apo inicie që shprien në fenomene terroriste, duke i bërë njëkohësisht objekt analize e bashkëpunimi.

b) Duke zvogëluar ekspozimin e vendit, duke mbrojtur zonat që janë shumë të rëndësishme për funksionimin e tij dhe duke reaguar në mënyrë efektive në rastin e një incidenti.

Të parashikohen e përfundojnë aktet e nevojshme ligjore dhe normative për objekte strategjike apo të rëndësishme të vendit, të cilat mbeten në vëmendjen e planeve të individëve apo grupeve terroriste dhe që mund të sjellin pasoja të rënda për vendin. Për këtë fakt të parashikohen edhe rrugët për zgjidhjet e situatave që mund të lindin nga përgatitjet apo tentativat e mundshme terroriste.

KREU IV

4.1 Politikat

Politikat prioritare që do të shërbejnë për një mbrojtje të mjaftueshme nga terrorizmi:

Parandalimi:	Ndalimi i radikalizmit dhe mbështetjes për terrorizmin dhe ekstremizmin
Ndjekja:	Informacionet e përpunuara dhe hetimet që kryhen për të ndërprerë aktivitetet terroriste.
Mbrojtja:	Të sigurohet që infrastruktura dhe interesat tona brenda dhe jashtë vendit janë të mbrojtura nga terroristët dhe ekstremistët.
Reagimi:	Zbutja e efektit të sulmeve duke hartuar plane emergjencash për rastet e sulmeve terroriste, duke trajnuar punonjësit që do të reagojnë të parët dhe duke u siguruar që çdo reagim të jetë i koordinuar dhe i testuar.

Parandalimi

Grupet terroriste dhe ekstremiste do të përpiqen vazhdimisht të rekrutojnë individë me qëllim që të mbështesin objektivat e tyre në përgjithësi, ose për të zhvilluar aktivitete operacionale ose për të mbledhur fonde. Ky proces rekrutimi në mënyrë të pashmangshme do të përfshijë një shkallë të lartë indoktrinimi, ose radikalizmi ndaj individëve apo grupi personash të prirur për pikëpamje të tilla, që në thelb shndërrohet në rrezik real për vendin.

Për sa më sipër, themi se qëllimi është që të parandalojë çdo indicie apo fenomen që prodhon ekstremizëm dhe terrorizëm, duke mundësuar marrjen e masave në kohë për zbulimin dhe dokumentimin e këtij aktiviteti kriminal.

Në qendër të vëmendjes së punës për kapjen e këtyre objektivave do ndiqen politika të qarta, të cilat do të përfshijnë:

a) Ndërprerjen e aktiviteteve të ekstremistëve

Do të punohet me masa zbuluese e parandaluese për të siguruar ndërprerje të aktivitetit kriminal të grupeve dhe individëve që promovojnë ose mbështesin dhunën. Për këtë do të përcaktohen politika konkrete administrativo-profesionale, që do të mundësojnë kapjen e objektivave të kërkuara.

b) Mbështetjen e individëve që gjykohen se janë të ekspozuar ndaj ekstremizmit dhe radikalizmit

Për vepra terroriste të kryera në botë, individë të caktuar janë radikalizuar dhe kanë hyrë në rrugën e dhunës dhe shkatërrimit. Qëllimi është që të identifikohen këta individë në një fazë të hershme (përpara se të kryejnë një akt kriminal), duke i siguruar që ata do të kenë mbështetje ligjore deri në atë shkallë sa ata të shkëputen nga aktiviteti ekstremist dhe të braktisin rrugën që i çon drejt ekstremizmit të dhunshëm. Këto masa do të shoqërohen me akte të nevojshme ligjore dhe administrative që garantojnë fazat permanente të bashkëpunimit me këta individë.

c) Kontrollin e pakënaqësive që mund të çojnë në radikalizëm dhe ekstremizëm

Padrejtsitë ose pakënaqësitë që konstatohen, ose mungesa e tolerancës ndërmjet grupeve të komunitetit, mund të kenë një ndikim mbi shkallën që një individ do të pranojë radikalizmin dhe ekstremizmin.

Angazhimi me komunitetet e izoluara për të kontrolluar në mënyrë efektive diferencat e tyre do të çojë në pakësimin e tensioneve dhe të radikalizmit.

Ndjekja

Ndjekja përfshin aktivitetet e mbledhjes së informacioneve dhe hetimit që nevojitet për të ndërprerë terrorizmin.

E rëndësishme për sa i përket drejtimit të “Ndjekjes” është koncepti se pavarësisht se janë krime, proceset e mbledhjes së informacioneve/hetimeve janë shumë të ndryshme kur krahasohen me aktivitetin kriminal në përgjithësi. Këto diferenca përfshijnë:

a) Dimensionin ndërkombëtar të terrorizmit

Është diçka e rrallë që aktivitetet e terroristëve të kufizohen krejtësisht brenda kufijve të një shteti të vetëm; këto aktivitete terroriste nxjerrin si domosdoshmëri bashkëpunimin dypalësh ose shumëpalësh ndërmjet shteteve.

b) Marrëdhëniet ndërmjet punonjësve që kryejnë hetime dhe strukturave që mbledhin informacione

Për shkak të natyrës së fshehtë të aktiviteteve të terroristëve, mbledhja e informacioneve në mënyrë të fshehtë është faktori kryesor për të siguruar që grupet terroriste të zbulohen dhe të ndërpritet aktiviteti i tyre. Si rrjedhim, aktiviteti i ndjekjes duhet patjetër të udhëhiqet nga informacioni i përpunuar.

Me rëndësi shumë të madhe në të gjitha aktivitetet e ndjekjes është bashkëpunimi dhe puna në grup ndërmjet institucioneve.

Ngjarjet në vendet e tjera kanë treguar se probleme të caktuara mund të lindin kur institucionet nuk arrijnë të komunikojnë në mënyrë efektive, ose nuk i vlerësojnë informacionet e tyre së bashku. Si rrjedhim, është me rëndësi shumë të madhe bashkëpunimi dhe puna në grup ndërmjet institucioneve të përfshira në kontrollin e kërcënimit nga terrorizmi.¹

¹ Komisioni Kombëtar për sulmet terroriste kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Komisioni 9/11/)



c) Mënyrat e ndryshme (modus operandi) që përdoren nga grupet terroriste

Grupet terroriste kanë tendencën që të mësojnë nga përvoja dhe aftësitë e grupeve të tjera, me qëllim që të kenë avantazh ndaj strukturave të mbledhjes së informacionit/zbatimit të ligjit.

Për sa i përket strukturave kundër terrorizmit, Shërbimi Informativ Shtetëror luan rol kryesor në mbledhjen e informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave kontribuon me grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit financiar dhe me masat bllokuese, ndërsa Policia e Shtetit ka përgjegjësi për hetimin. Prokuroria e Përgjithshme siguron mbikëqyrjen nga pikëpamje juridike e procedurave të hetimit dhe mbledhjes së informacionit. Ashtu si në shumicën e shteteve, Shërbimi Doganor luan rol kryesor në hetimin e disa formave të terrorizmit (përhapja e artikujve me përdorim të dyfishtë dhe hetimi i rasteve të tilla). Në të njëjtën mënyrë, Shërbimi Informativ i Ushtrisë mban përgjegjësi për mbledhjen e informacioneve mbi rreziqet për sigurinë kombëtare.

Mbrojtja

Qëllimi i këtij drejtimi të punës është të sigurojë që infrastruktura kombëtare dhe interesat tona brenda dhe jashtë vendit janë të mbrojtura nga terroristët dhe ekstremistët. Qëllimi është që të zvogëlohet shkalla e ekspozimit të vendit dhe interesave të tij në rast të planifikimit të një sulmi.

Fushat e mbrojtjes mund të përfshijnë:

a) Infrastrukturën e rëndësishme kombëtare

Infrastruktura e rëndësishme kombëtare siguron shërbimet themelore për publikun. Përvoja nga komuniteti ndërkombëtar ka treguar se sistemet e transportit, portet, hidrocentralet/termocentralet dhe zyrat e qeverisë/diplomatike kanë qenë objekt i sulmeve të terroristëve dhe i sabotatorëve. Sulme të tilla do të kenë pasoja të mëdha ekonomike dhe mund të çojnë në humbje jetësh njerëzore.

Si përgjigje ndaj këtyre sulmeve, pjesë e përgjegjësive dhe roleve të Drejtorisë së Emergjencave Civile është që të identifikojë dhe kontrollojë rreziqet ndaj infrastrukturës kombëtare dhe të hartojë planet përkatëse të emergjencave.

b) Kontrollin kufitar

Gjatë viteve të fundit ka pasur zhvillime në të gjithë gamën e aktiviteteve policore përgjatë kufijve kombëtarë, përfshirë përdorimin e teknologjisë biometrike dhe përmirësimin e analizës së të dhënave.

Me përmirësimin e mjeteve të telekomunikacionit dhe medias, terroristët dhe grupet e krimit të organizuar po përdorin gjithnjë e më shumë takimet personale dhe lëvizjen e parave të thata për të çuar më tej qëllimet dhe objektivat e tyre. Ndalimi i personave të tillë që në kufijtë shtetërorë ofron një mundësi për të ndërprerë aktivitetet e tyre në një fazë të hershme, si dhe mbledhjen e informacioneve të rëndësishme.

Drejtorja e Policisë Kufitare dhe Shërbimi Doganor janë institucionet kryesore të përfshira në aktivitetin e “mbrojtjes” në kufijtë kombëtarë.

c) Grumbullimet e njerëzve (vendet ku ka numër të madh njerëzish)

Aktivitetet sportive dhe pikat kryesore turistike/të transportit i krijojnë mundësi terroristëve dhe ekstremistëve që të zhvillojnë aktivitetet e tyre, të cilat kanë gjasa të kenë publicitet të madh.

Për sa i përket aktiviteteve sportive, shumë prej rreziqeve mund të pakësohen duke ndërmarrë masa efektive kontrolli dhe duke hartuar plane për sigurinë e aktivitetit. Pikat kryesore turistike/të transportit kërkojnë marrjen e masave të specializuara të sigurisë dhe mund të kërkojnë që ato të përputhen me kërkesat e agjencive të huaja të transportit (si për shembull, siguria e aviacionit dhe transportit detar).

Reagimi

Fushat kryesore në këtë drejtim të punës do të jenë:

a) Të sigurohet që procedurat shtetërore mund të trajtojnë në mënyrë efektive rrezikun nga terrorizmi.

Gjatë viteve të fundit komuniteti ndërkombëtar ka ngritur forume për shkëmbimin e informacionit mbi tendencat terroriste dhe *modus operandi*. Brenda Europës disa prej këtyre forumeve janë krijuar me mbështetjen e Bashkimit European, ndërsa disa të tjerë janë krijuar ndërmjet strukturave të ndryshme policore që luftojnë kundër terrorizmit/mbledhin dhe analizojnë informacione (si për shembull: Grupi i punës policor mbi terrorizmin, Qendra Ndërkombëtare e të dhënave për bombat).

b) Të sigurohet se ekzistojnë kapacitetet e duhura për të trajtuar një incident terrorist.

Nëse një incident shfaqet, është e mundshme të përfshijë një përgjigje të menjëhershme dhe të koordinuar nga të gjitha shërbimet e emergjencave, shërbimi shëndetësor dhe struktura të tjera qeveritare. Do kërkohej përcaktim i saktë i fazave për përballimin e incidentit dhe mbulimit të pasojave, të cilat duhen planifikuar ekzaktësisht që para ndodhjes së tij.

c) Hartimi i planeve të emergjencave (përfshirë kthimin në normalitet)

Hartimi i planeve të emergjencave mund të shihet si dy çështje të veçara: proaktive dhe reaguese.

Proaktive: thelbësore për këtë strategji kundër terrorizmit është koncepti se çdo përgjigje duhet të jetë në përputhje me vlerësimin e plotë strategjik të rrezikut.

Reaguese: hartimi i planeve të emergjencave për të mbajtur nën kontroll pasojat e një incidenti terrorist (të ngjashme me planet për emergjencat civile).

d) Vazhdimësia e punës/aktiviteteve

Vijimësia e punës është procesi i kontrollit dhe drejtimit të infrastrukturës së rëndësishme kombëtare/institucioneve me rëndësi jetike në rastin e një incidenti me pasoja në një shkallë të gjerë/katastrofike.

4.2 Objektivat e strategjisë

Për të arritur vizionin, si dhe për të realizuar misionin e strategjisë përcaktohen objektiva të përgjithshëm, si dhe objektiva afatshkurtër, afatmesme e afatgjata.

- Objektiva afatshkurtër janë ato që do të arrihen në periudhën 2011-2012.

- Objektiva afatmesëm janë ato që do të arrihen në periudhën 2011-2013.

- Objektiva afatgjatë janë ato që do të arrihen në periudhën 2011-2015.

Objektiva afatshkurtër (2011-2012)

- Ripunimi e azhurnimi i të gjithë planeve të veprimit të hartuara deri në miratimin e kësaj strategjie, hartimi i planeve të veprimit të reja nga të gjitha institucionet që nuk kanë pasur të tilla deri tani dhe që marrin detyra sipas drejtimeve të krimit të terrorizmit. Këto plane të hartohen sipas fazave që përcakton kjo strategji.

- Krijimi dhe konsolidimi i strukturave në funksion të kërkesave apo të parashtruara në strategjitë e tjera, rishikimi i komiteteve, komisioneve, sekretarive apo çdo funksion tjetër i krijuar nga strategjitë sektoriale me qëllim zgjerimin e kompetencave apo funksionimin e tyre për të gjithë drejtimet e luftës kundër terrorizmit.

- Përgatitja dhe përqasja e legjislacionit sipas standardeve të BE-së, në lidhje me luftën kundër krimit të terrorizmit, si dhe akteve të tjera të funksionimit të strukturave që kanë përgjegjësi për këtë drejtim, bazuar në strategjitë e tjera, si dhe në planet e veprimit.

- Hartimi i të gjitha akteve të nevojshme që do të thellojnë bashkëpunimin me struktura homologe të vendeve të rajonit e më gjerë në luftën kundër krimit të terrorizmit.

- Krijimi i një sistemi të transmetimit të informacionit brenda strukturave të përfshira në luftën kundër krimit të terrorizmit.



- Përfundimi i sistemeve të IT-të për transmetimin e analizën e informacionit që bën fjalë për vepra penale të krimit të terrorizmit.

- Zgjerimi i aplikimit të teknikave të reja të investigimit, brenda suazës së përcaktuar në ligj, për të gjitha format e shfaqjes së krimit të terrorizmit.

- Identifikimi i analizës e situatës së grupeve kriminale që kryejnë, apo dyshohet se kryejnë vepra penale të lidhura me terrorizmin.

- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për specialistët që punojnë në strukturat që kryejnë veprimtari kundër krimit të terrorizmit dhe shfrytëzimin e eksperiencave të vendeve të tjera në këtë drejtim.

- Zhvillimi dhe thellimi i transparencës për komunitetin në lidhje me kujdesin dhe vigjilencën për parandalimin dhe zbulimin e terrorizmit dhe ekstremizmit.

Objektiva afatmesëm (2011-2013)

- Forcimi dhe realizimi i një kontrolli efektiv të kufirit shtetëror, si dhe të të huajve të dyshimtë, duke iu përafëruar standardeve të vendeve të BE-së.

- Krijimi i një baze të dhënash për shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit apo të huaj të dyshimtë me qëndrim në vendin tonë dhe që ka informacione se kryejnë vepra penale në ato vende në lidhje me krimin e terrorizmit.

- Thellimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit, si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të terrorizmit.

- Kryerja e studimeve të plota për ecurinë e punës në drejtim të goditjes e parandalimit të formave të ndryshme të krimit të terrorizmit, përcaktimi i nevojave materialo-financiare për strukturat që operojnë në këtë drejtim dhe plotësimi i tyre mbi bazën e mundësive që ka çdo institucion.

- Ngritja e një sistemi raportimi e monitorimi për rezultatet e hetimeve e gjykimeve të rasteve të krimit të terrorizmit apo ekstremizmit, të sekuestrimit të pasurive që rrjedhojnë nga veprimtaria e tyre kriminale, si dhe tentativave të pastrimit të parave.

- Kryerja e analizave të përbashkëta midis institucioneve të gjurmimit, hetimit e gjykimit lidhur me grupe kriminale të hetuara e gjykuara për terrorizëm, në funksion të marrjes së masave parandaluese.

- Krijimi i një sistemi të informatizuar statistikor midis institucioneve që gjurmojnë, hetojnë apo gjykojnë çështje të krimit të terrorizmit.

Objektivat afatgjatë (2011-2015)

- Realizimi i parandalimit të akteve të mundshme terroriste në vendin tonë apo nëpërmjet vendit tonë.

- Hartimi i një sistemi ligjor apo akteve të tjera sipas standardeve të BE-së dhe që krijon hapësirën e duhur apo instrumentet e nevojshme për parandalimin e goditjen e krimit të terrorizmit.

- Paraqitja e strukturave të specializuara të shtetit të afta profesionalisht dhe të angazhuara maksimalisht në drejtim të identifikimit e goditjes së krimit të terrorizmit.

- Realizimi i ndjekjes, parandalimit, mbrojtjes dhe reagimit ndaj fenomeneve që prodhojnë radikalizëm dhe ekstremizëm nga persona apo grup personash, të evidencuara në fazën e parë dhe të dytë të kësaj strategjie, duke identifikuar moton “se asnjë person apo grup kriminal që kryen krime të formave të krimit të terrorizmit nuk do t’i shpëtojë ndëshkimit të ligjit”.

- Paraqitja e strukturave të shtetit shqiptar si partnerë të aftë profesionalisht, të barabartë dhe të besueshëm për strukturat homologe të vendeve të tjera.

- Përgatitja e materialeve studimore nga specialistët që merren me luftën kundër terrorizmit, duke përcaktuar nivelin e kërcënimit terrorist në rrafshin ndërkombëtar dhe ndikimet e tij në vendin tonë, format që ata përdorin për të arritur qëllimet e tyre.

- Sekretariati teknik, krijuar posaçërisht për ndjekjen e problemeve që lidhen me çështjet e terrorizmit, herë pas here të monitorojë detyrimet që rrjedhin në këtë dokument strategjik dhe operacional, duke hartuar rekomandimet e nevojshme dinamike.

- Strukturat informative përkatëse dhe ato hetimore, të bëjnë analiza të përbashkëta për procese të ndjekura, të hetuara apo gjurmua, që flasin për vendosje bombash në ndërtesa apo mjedise publike, organizime me karakter ideologjik, anarkist, ekstremist, fetar apo nacionalist, duke nxjerrë motivet dhe përcaktuar detyra me theks parandalues dhe infiltrues.

- Analiza dhe përshtatje efektive të të dhënave informative të zbulimit me çështjet hetimore në ndjekje, monitorimi dhe zbulimi i potencialeve të personave që ndiqen për indicie apo fenomene ekstremiste, apo janë burim i armëve dhe eksplozivëve, armëve kimike, biologjike, radioaktive apo bërthamore, financimeve dhe propagandës së këtij lloji.

- Sigurimi dhe mbrojtja në maksimumin e nevojshëm e personelit që do të merret me luftën kundër terrorizmit, duke ruajtur profilizimin dhe cilësinë, që nënkuptojnë frymë profesionale kolegjaliteti dhe ndërthurje informative me ato hetimore. Të vlerësohet dhe kuptohet përfundimisht se hetimet e terrorizmit kombëtar dhe ndërkombëtar janë njëkohësisht “ zbulimi ” dhe “ hetimet kriminale”. Për këtë të bëhen propozimet përkatëse.

- Meqenëse lufta kundër terrorizmit mbetet një nga prioritetet kryesore të qeverisë, të bëhen propozimet e nevojshme për trajtimin e veçantë, me fonde mjedise e mjete të nevojshme, duke e shoqëruar edhe me akte të nevojshme normative.

- Hartimi dhe zbatimi i programeve bashkëkohore ushtrimesh, për zhvillimin e aftësive në planifikimin dhe përballimin e emergjencave, duke vënë në provë të plotë sistemet, praktikrat dhe procedurat. Për këtë qëllim të hartohen praktikrat më të mira, të evidentohen pikat e dobëta dhe të sanksionohen reagimet pozitive ndaj një sulmi terrorist. Çdo institucion që detyrohet të zbatojë masat e nevojshme, të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm.

- Përcaktimi i kontureve të plota dhe hartimi i një dokumenti tip, mbi dhënien urgjent të informacionit mbi një sulm terrorist, si për median vizive apo të shkruar, ashtu edhe për institucionet përkatëse e qeverinë. Njëkohësisht përcaktimi i qendrave të informacionit pranë skenës së krimit, personat kompetent ekzekutiv, hetimor apo ndihmës, që do të mundësojë koordinimin e prioriteteve të analizës së informacionit (strategjike/taktike/evidentuese etj.), për të mbledhur, vlerësuar dhe shpërndarë informacionin përkatës.

- Meqë terroristët kanë perfeksionuar format dhe metodat, shtrohet nevoja urgjente që strukturat informative përkatëse të perfeksionojnë veprimet praktike në dhënien e “gatishmërisë” së informacionit parandalues apo reagues, duke bërë propozimet përkatëse.

- Ndërmjet strukturave informative, veçanërisht ndërmjet Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Departamentit të Hetimit të Krimeve, të krijohet reciprokisht terminali i nevojshëm i hyrjes në informacionin e kërkuar, duke vendosur pika të miratuara kontakti mes njëri-tjetrit. Gjithashtu, të krijohet mundësia e perfeksionimit të teknologjisë së informacionit për t’u përdorur mes njëri-tjetrit.

KREU V PROCESI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT

5.1 Përgjegjësitë e institucioneve të veçanta

Detyrat konkrete për institucionet:

- Të marrin detyrimet e përcaktuara në këtë strategji dhe të hartojnë plane veprimi apo programe pune për implementimin e tyre sipas fazave të parashikuara në këtë strategji. Planet e veprimit apo programet e punës do të bëhen pjesë e kësaj strategjie dhe do të monitorohen bashkërisht.



- Të ngrenë menjëherë grupet e punës për implementimin e detyrave të tyre, si dhe të përcaktojnë pikat e kontaktit, përgjegjëse për raportimin e koordinimit dhe të zbatimit të detyrave të përcaktuara në strategji.

Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit)

- Të marrë përgjegjësinë e hartimit të nismave për koordinim, si dhe bashkëveprim midis institucioneve të ndryshme të përmendura në këtë strategji.

- Të grumbullojë planet e veprimit apo programet e punës të të gjithë institucioneve të tjera dhe t'i bëjë pjesë të kësaj strategjie. Për këtë të hapë një dosje të veçantë sipas standardeve, e cila të mbahet nga sektori kundër akteve terroriste.

- Të ndjekë dhe marrë iniciativën për ripunimin e azhurnimit të strategjive të tjera sektoriale me politikat dhe objektivat e parashikuara në këtë strategji.

Ministria e Drejtësisë

Të hartojë detyra të veçanta në zbatim të objektivave të strategjisë dhe të japë ndihmesën e saj në hartimin e akteve ligjore të parashikuara në këtë strategji, si dhe në strategjitë sektoriale.

Ministria e Financave

Të ndjekë dhe zbatojë detyrat që lidhen me aktet ligjore e normative sipas drejtimeve përkatëse të institucioneve në varësi, në funksion të parandalimit të akteve terroriste.

DPPPP

Të nxjerrë e zbatojë teknikat në funksion të parandalimit të terrorizmit dhe t'ua bëjë të njohura subjekteve të ligjit, si dhe të ndjekë me prioritet të veçantë përditësimin e listës së personave të shpallur si financues të terrorizmit dhe marrjen e masave ndaj tyre.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Të administrojë pasuritë e sekuestruara të subjekteve të shpallura si financuese të terrorizmit, duke bllokuar burimet e të ardhurave të krijuara nëpërmjet tyre.

Prokuroria

Të hartojë detyra të veçanta për zbatimin e objektivave të përcaktuar në këtë strategji për organin e prokurorisë.

Shërbimi Informativ Shtetëror

Të hartojë detyra të veçanta për zbatimin e objektivave në drejtim të luftës kundër krimit të terrorizmit.

Ministria e Mbrojtjes

Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të strategjisë për këtë institucion, sidomos në drejtim të shkëmbimit të informacionit, në krijimin e kapaciteteve dhe aseteve ushtarake, për përdorim të integruar të tyre edhe nga institucionet e tjera shtetërore, si dhe për vënien e tyre në dispozicion të organizmave ndërkombëtare në kuadër të luftës kundër terrorizmit.

Ministria e Punëve të Jashtme

Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie, sidomos në fushën e bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me homologët e huaj e organizatat ndërkombëtare.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie duke u fokusuar: “Për luftën kundër fenomenit të ekstremizmit dhe radikalizmit në mjediset shkollore”.

Ministria e Mjedisit

Të ndjekë dhe analizojë problemet mjedisore dhe vatrat e rrezikshme nga ku mund të vijnë pasoja infektive të rënda, duke informuar dhe marrë masat për eliminimin dhe parandalimin e përhapjes së pasojave.

Ministria e Shëndetësisë

Të ndjekë me përparësi funksionimin e sistemit të njoftimit, izolimit apo transportimit (të mostrave biologjike), si dhe analizimin e medikamenteve për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse me karakter të veçantë. Njëkohësisht të ndjekë detyrat nëpërmjet zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet.

Ministria e Bujqësisë

Të monitorojë masat ligjore e normative për parandalimin e përhapjes së rrezikut bioterrorist, kryesisht efekteve të sëmundjeve të ndryshme me origjinë mjedisore.

5.2 Monitorimi

Monitorimi është procesi i pasqyrimin të implementimit të strategjisë së luftës kundër krimit të terrorizmit, si dhe arritjen e objektivave të parashikuar për këtë qëllim.

Vendimi nr.1140, datë 30.7.2008 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit”, i ndryshuar, parashikon ngritjen e Komitetit Këshillues për Masat kundër Krimit të Organizuar pranë Këshillit të Ministrave, e cila do të jetë struktura përgjegjëse për monitorimin e kësaj strategjie. Deri në ngritjen dhe vënien në funksionim të këtij Komiteti, kjo përgjegjësi i përket Grupit Ndërmnistror të Punës në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr.164, datë 27.7.2006 dhe Sekretariatit Teknik, të ngritur me urdhrin të Ministrit të Brendshëm. Ministria e Brendshme, nëpërmjet Sekretariatit Teknik do të përgatisë buletin vjetor, bazuar në raportimet që do të bëjnë institucionet e tjera, duke kryer detyrat e mëposhtme:

- Të grumbullojë detyrat e veçanta të të gjitha institucioneve të tjera;
- Të marrë iniciativën për ripunimin e azhurnimit të strategjive të tjera sektoriale me politikat dhe objektivat e parashikuara në këtë strategji.

Monitorimi i këtyre rezultateve do të jetë i brendshëm dhe i jashtëm. Monitorimi i brendshëm do të vlerësojë progresin e bërë duke u mbështetur te indikatorët:

Si indikatorë të brendshëm do të jenë:

- shkatërrimi i grupeve kriminale të përfshira në këto aktivitete;
- sekuestrimi i pasurive të rrjedhura nga këto aktivitete të paligjshme;
- arrestimi i personave me karrierë kriminale;
- treguesit e tregut të paligjshëm;
- përdorimi i formave dhe mjeteve të veçanta të hetimit;
- paraqitja e një situatë të sigurt në vend e standarde të mira të rendit.

Si indikatorë të jashtëm do të jenë:

- vlerësimet e publikut, të qytetarëve dhe të bizneseve të ndryshme nëpërmjet matjes së perceptimit të publikut duke përdorur pyetësorë, intervista dhe organizuar forume të hapura;
- vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare, në raporte periodike apo buletine;
- vlerësimet e vendeve të rajonit për treguesit e minimizimit të krimit të terrorizmit në Shqipëri.

Të gjitha institucionet e tjera do të dërgojnë një raportim të plotë për masat e marra lidhur me implementimin e kësaj strategjie, si dhe strategjive të tjera çdo fund 3-mujori në Ministrinë e Brendshme, duke shpjeguar dhe arritjet e realizuara nga implementimi i masave.

Qeveria do të marrë në analizë punën e institucioneve të përmendura në këtë strategji në drejtim të luftës kundër krimit të terrorizmit çdo vit, si dhe do të bëjë publike arritjet pas çdo faze të implementimit të objektivave e planeve të veprimit, si dhe pasqyrojë arritjet kundër krimit të terrorizmit.

Burimi i financimit për vënien në zbatim të kësaj strategjie, parashikohet nga buxheti përkatës i institucioneve që kanë detyrime dhe marrin pjesë në luftën kundër terrorizmit.



PLANI I VEPRIMIT
PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT
2011-2015

Objektivat e strategjisë	Mënyrat e veprimit	Institucionet zbatuese	Afatet kohore	Kostot financiare dhe kush e mbulon
1. Ripunimi e azhurnimi i planit të veprimit të hartuara deri në miratimin e kësaj strategjie, hartimi i planeve të veprimit të reja nga të gjitha institucionet që nuk kanë pasur të tilla deri tani dhe që marrin detyra për luftën kundër terrorizmit. Planet e veprimit të hartohen sipas fazave që përcakton kjo strategji.	1.1 Të ngrihet grupi i punës ndërinstitucional i cili do të ketë si mision: a) Të bëjë vlerësimin dhe analizën e realizimit të detyrave të parashikuara në Planin kombëtar për luftën kundër terrorizmit. b) Të hartojë draftin dhe të propozojë ndryshimet e nevojshme për një plan veprimi të ri.	Këshilli i Ministrave, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, SHISH	Fundi i vitit 2011	Mbulohet nga buxheti i institucioneve. 130 820 M. Brendshme Kosto administrative
2. Krijimi i strukturave efektive, mbështetur në kërkesat e parashtruara para dhe gjatë përgatitjes së strategjisë, rishikimi i komiteteve, komisioneve, sekretarive apo çdo funksion tjetër i krijuar nga strategjitë sektoriale me qëllim zgjerimin e kompetencave apo funksionimin e tyre edhe për luftën kundër terrorizmit.	2.1 Të ngrihet një grup pune ndërinstitucional i cili do të ketë si mision hartimin e një akti normativ për funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional për Bashkërendimin e Luftës Kundër Terrorizmit. 2.2 Të azhurnohen veprimet e strukturave të antiterrorit me zyrën e gjurmimit të aseteve kriminale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.	Këshilli i Ministrave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, SHISH,	Dhjetor 2011	Mbulohet nga buxheti i institucioneve. Kosto administrative.
3. Studimi, hartimi, përgatitja dhe përqasja e legjislacionit sipas standardeve të BE-së, në lidhje me luftën kundër terrorizmit.	3.1 Të ndiqen procedurat për ndryshimet e nevojshme ligjore dhe normative për riorganizimin e strukturave që merren me ndjekjen e problemeve për krimet terroriste.	Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, SHISH, Prokuroria e Përgjithshme,	Në vazhdim	Nuk ka kosto.

	3.2 Hartimi i një ligji të plotë e sipas standardeve europiane për luftën kundër terrorizmit. 3.3 Të rishikohen dhe përmirësohen mënyrat e bashkëpunimit midis agjencive përkatëse me organizmat ndërkombëtare dhe OJQ –të, me synimin e vendosjes së kontakteve të vazhdueshme. 3.4 Të ndiqen detyrat e miratuara nga Këshilli i Ministrave, për funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional kundër Terrorizmit. 3.5 Të përgatitet rregullorja për funksionimin e strukturave të antiterrorit.	Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financës, Prokuroria e Përgjithshme, SHISH		
4. Hartimin e gjithë akteve të nevojshme që do të thellojnë bashkëpunimin me strukturat homologe të vendeve të rajonit e më gjerë në luftën kundër krimit të terrorizmit	4.1 Negocimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja dy dhe shumëpalëshe për luftën kundër terrorizmit.	Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë	Në vazhdim	Nuk ka kosto
5. Krijimi i një sistemi të transmetimit të informacionit brenda strukturave të përfshira në luftën kundër terrorizmit. Përfundimi i sistemeve të IT-së për transmetimin e analizën e informacionit që bën fjalë për vepra penale të terrorizmit.	5.1 Do të implementohet shtrirja e sistemit të analizës së informacionit kriminal-MEMEX në të gjitha drejtoritë e policisë në qarqe.	Ministria e Brendshme	Në vazhdim	Mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Brendshme
6. Evidentimi dhe parandalimi i rasteve dhe fenomeneve që lidhen me radikalizmin dhe ekstremizmin.	6.1 Do të vazhdojë ndjekja, parandalimi dhe mbrojtja nga veprimtaria e individëve apo grupeve kriminale që tentojnë të merren me organizime, nxitje apo rekrutime për kryerje aktesh terroriste. 6.2 Çdo vit të hartohet një komunikatë për rrezikun e fenomeneve që prodhojnë radikalizëm apo	Ministria e Brendshme, SHISH, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, SHISH	Në vazhdim	Nuk ka kosto



	ekstremizëm, si derivate të terrorizmit.			
7. Zgjerimi i aplikimit të teknikave të reja të investigimit, brenda suazës së përcaktuar në ligj, për të gjitha format e shfaqjes së terrorizmit.	7.1 Aplikimi në përputhje me ligjin procedural penal, i formave dhe metodave speciale të hetimit si një ndër mjetet më rezultative në luftën kundër aktivitetit kriminal në fushën e terrorizmit. 7.2 Forcimi i kapaciteteve për përdorimin e metodave speciale të hetimit nëpërmjet përmirësimit të pajisjeve dhe trajnimeve të vazhdueshme të punonjësve në bashkëpunim dhe me partnerët ndërkombëtarë. 7.3 Krijimi i një njësie speciale që do trajnohet dhe profilizohet për ndjekjen e individëve apo grupeve me prirje radikale apo ekstremiste.	Ministria e Brendshme, Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në vazhdimësi	Ministria e Brendshme 1 200 000 2 000 000
8. Identifikimi dhe analizimi i situatës së grupeve kriminale që kryejnë, apo dyshohet se kryejnë vepra penale të lidhura me krimin e terrorizmin.	8.1 Në bazë të urdhrin nr.996, datë 1.9.2009 “Për miratimin e udhëzuesit për vlerësimin e rrezikshmërisë së grupeve kriminale”, çdo fund viti do të bëhet analizimi i situatës së informacioneve, individëve apo grupeve që shfaqen me fenomene apo indicie për radikalizëm duke përcaktuar shkallën e rrezikshmërisë së tyre.	Ministria e Brendshme, SHISH	Në vazhdimësi.	Nuk ka kosto
9. Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme profesionale për specialistët që punojnë në strukturat kundër terrorizmit. Shfrytëzimi i eksperiencave të vendeve të tjera në këtë drejtim.	9.1 Në bashkëpunim me departamentin e trajnimeve dhe partnerëve të tjerë të hartohen kurrikulat për trajnimin e vazhdueshëm të strukturave kundër krimit të terrorizmit, me qëllim ngritjen e	Ministria e Brendshme	Në vazhdim	Mbulohet nga buxheti i Ministrisë Brendshme dhe burime nga institucione partnere 800 000

	kapaciteteve të punonjësve. 9.2 Trajnimi i të gjithë punonjësve të policisë që merren me luftën kundër akteve terroriste, duke detajuar inicimet apo fenomenet e radikalizmit dhe ekstremizmit. 9.3 Trajnimi dhe bashkëpunimi në vazhdimësi i strukturave të antiterrorit me ato të hetimit të krimit financiar me teknikat e reja të hetimit të pastrimit të parave dhe gjurmimit, zbulimit e sekuestrimit të aseteve kriminale.			
10. Zhvillimi dhe thellimi i transparencës për komunitetin në lidhje me goditjen e fenomeneve që prodhojnë radikalizëm apo ekstremizëm.	10.1 Forcimi i bashkëpunimit midis të gjitha strukturave policore dhe shoqërisë civile, me qëllim shkëmbimin e informacionit në lidhje me të gjitha format e radikalizmit dhe ekstremizmit. 10.2 Në bashkëpunim me punonjësit e policisë së policimit në komunitet, të organizohen takime me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin e të gjitha formave të radikalizmit dhe ekstremizmit, si forma të dukshme të terrorizmit. 10.3 Rritja dhe përmirësimi i bashkëpunimit midis policisë që merret me luftën kundër terrorizmit dhe Komitetit Shtetëror të Kulteve pranë Ministrisë së Kulturës. 10.4 Rritja e bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale, objektet e	Ministria e Brendshme	Në vazhdim	Nuk ka kosto



	rëndësishme, entet e kultit, etj., me qëllim sensibilizimin për forcimin e rregullave në ruajtje dhe regjimin e hyrje-daljeve etj.			
11. Forcimi i rregullave në ruajtjen e kufirit shtetëror, të shtetasve shqiptarë apo të të huaj që përfshihen në listat e kontrollit duke iu përfruar standardeve të BE-së.	11.1 Bashkëpunimi në Policinë Kufitare dhe të migracionit, me qëllim marrjen e masave për parandalimin dhe zbulimin e rasteve që dyshohet për akte terroriste.	Ministria e Brendshme	Në vazhdim	Nuk ka kosto
12. Realizimi i masave për të garantuar menaxhimin e integruar të kufirit	12.1 Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë kombëtare të zbatimit të ligjit për të mundësuar zbulimin dhe parandalimin e akteve të mundshme terroriste. 12.2 Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar me agjencitë homologe të vendeve fqinje dhe më gjerë, kjo dhe në bazë të marrëveshjeve të miratuara për këtë qëllim. 12.3 Rritja e kapaciteteve të Policisë Kufitare dhe Migracionit, trajnimi i vazhdueshëm i tyre në drejtim të luftës kundër krimit ndërkufitar dhe terrorizmit. 12.4 Evidentimi i aktivitetit të kundërligjshëm nëpërmjet kufirit shtetëror dhe rritja e kapaciteteve për hetimin e veprave penale që ndjek Pk dhe M, duke i lidhur me fenomenet e dyshimet për akte të mundshme terroriste.	Ministria e Brendshme	Në vazhdim	Kosto administrative (burime njerëzore)
13. Përsosja e teknikës në përdorim të Policisë Kufitare dhe Migracionit, rritja e kapaciteteve të saj, që mundëson parandalimin dhe menaxhimin e situatave emergjente.	13.1 Informatizimi i shërbimeve të PK dhe M duke shtrirë linjat e komunikimit në të gjitha pikat e kalimit kufitar.	Ministria e Brendshme	Viti 2011	Mbulohet nga buxheti i Ministria e Brendshme 5 000 000

	13.2 Pajisja e PKK-ve me lexues të pasaportave biometrike.			
14. Garantimi i një trajnimi bashkëkohor, cilësor dhe të vazhdueshëm i strukturave të PK dhe M	14.1 Trajnimi i PK dhe M me aktet që normojnë funksionimin e policive kufitare të vendeve të BE-së, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të kërkuara. 14.2 Profilizimi i PK dhe M sipas llojeve të shërbimit që kryejnë dhe forcimi i trajnimit në fushën e sigurisë së kufijve detarë	Ministria e Brendshme	Në vazhdimësi	Kosto administrative (burime njerëzore të institucionit)
15. Parandalimi i fenomeneve të mundshme të ekstremizmit, kriminalitetit dhe terrorizmit në institucionet arsimore.	15.1 Nëpërmjet një arsimit cilësor dhe masiv synohet parandalimi i dukurive negative apo tendencat për to. Veprimtari: a) Përgatitja dhe ezaurimi i informacioneve me tematikë nga lufta kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe terrorizmit në veçanti, në të gjitha institucionet arsimore. b) Shfrytëzimi efektiv i orëve të lira për biseda e veprimtari ekstrakurrikulare lidhur me rreziqet e kriminalitetit, ndër ta dhe të terrorizmit. c) Aktivitete të përbashkëta e të planifikuara me bordin shkollor, shoqatën e prindërve dhe OJF-të. d) Anketime të përbashkëta mbi parandalimin e ekstremizmit etj. e) Marrja e masave dhe kryerje aktiviteteve në drejtim të sensibilizimit të nxënësve, prindërve e komunitetit në përgjithësi. f) Organizimi i aktiviteteve sportive e	MASH, IZHA Drejtoritë arsimore rajonale, Shkollat e larta. MASH DAR MASH Policia e Shtetit	Vazhdimisht	Parashikuar në PBA, 2011-2013, të programit buxhetor “ Planifikim menaxhim” Programi buxhetor “ Arsimit bazë parashikuar 10 orë në vit, për afërsisht 7400, klasa x 250 lekë/ora mësimore = 18.5 milionë lekë. Në programin e arsimit të mesëm parashikohen 10 orë në vit, për afërsisht 3760 klasa = 37 600 orë mësimore x 300 lekë/ora mësimore =11.3 milionë lekë.



	kulturore për të mbajtur fëmijët larg veseve dhe ekspozimit ndaj fenomeneve kriminale. g) Aktivitete të përbashkëta me Policinë e Shtetit h) Në shkollat me rrezikshmëri të lartë kryen veprimtari të përbashkëta sensibilizuese të planifikuara ose jo. i) Konsultime të vazhdueshme dhe organizimi i ruajtjes së përbashkët të mjediseve shkollore me (sinjalizim i menjëhershëm etj.) qëllim identifikimin e elementeve të dyshuar dhe neutralizimin e tyre.			Totali = 29, 8 milionë lekë
16. Transporti	16.1 Përcaktimi, koordinimi dhe zbatimi i masave përkatëse të sigurisë për parandalimin e akteve dhe ndërhyrjeve të jashtëligjshme në aviacionin civil.	MPPTT, Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC)	2011-2012	Kosto administrative
a) Transporti ajror				
b) Transporti rrugor	a.1 Organizimi i sigurisë në aviacionin civil në përputhje me standardet ndërkombëtare, hartimi dhe zbatimi i Programit Kombëtar të Sigurisë në Aviacionin Civil (PKSAC).	Ministria e Brendshme, Operatori i Aeroportit ("Tirana International Airport" sh.p.k.)	2012-2013	
c) Transporti hekurudhor	b.1 Vendorsja e rregullave standarde të kontrollit duke garantuar kryerjen e veprimtarisë së transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, sipas standardeve europiane.	MPPTT (DPSHTRR)	Vazhdimisht	Kosto financiare mbulohet nga shoqëria anonime
d) Transporti detar	b.2 Përgatitja e projektvendimit "Mbi procedurat uniforme në kontrollin e transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, sipas direktivës 95/50/EC.	Hekurudha Shqiptare sh.a., Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor	Vazhdimisht	Hekurudha Shqiptare dhe Policia e Shtetit
	b.3 Forcimi i mekanizmave për	Policia e Shtetit	Deri në dhjetor 2011	Mbulohet nga buxheti i institucioneve
		Hekurudha Shqiptare sh.a.	Deri në dhjetor 2011	Kosto financiare mbulohet nga shoqëria
		Drejtoria e Inspektimit	Deri në dhjetor 2011	

	sigurinë dhe mbrojtjen e instalimeve kryesore, impianteve, objekteve të rëndësishme dhe mjetet e transportit publik (trena) për parandalimin e akteve terroriste. c.1 Mbrojtja e sigurisë kombëtare dhe e rendit publik nëpërmjet kontrollit të sigurisë në linjën hekurudhore, veprat e artit dhe në trenat e udhëtarëve. c.2 Vëzhgimi i vazhdueshëm 24-orësh i infrastrukturës hekurudhore dhe i mjeteve lëvizëse në zbatim të ligjit nr.9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. d.1 Ngritja e sistemeve elektronike të kontrollit të hyrjeve dhe daljeve të gjithë personave, që futen dhe dalin në territoret e porteve të Republikës së Shqipërisë. d.2 Ngritja e sistemeve automatike të kontrollit të trafikut të mjeteve detare, që futen dhe dalin në territoret e porteve të Republikës së Shqipërisë. d.3 Pajisja e të gjitha forcave të sigurisë në porte me të gjitha mjetet e nevojshme për zbulimin dhe luftën kundër terrorizmit. Investim për ngritjen e sistemeve.	Hekurudhor Policia e Shtetit Portet e Republikës së Shqipërisë Kapitaneria e Përgjithshme e Porteve Forcat e sigurisë në porte		anonime Hekurudha Shqiptare dhe Policia e Shtetit
17. Hartimi i të gjitha akteve të nevojshme që do të thellojnë bashkëpunimin me struktura homologe të vendeve të rajonit e më gjerë në luftën kundër krimit të terrorizmit	17.1 Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me struktura homologe ndërkombëtare (anëtare të grupit EGMONT)	DPPPP	Në vazhdimësi	Nuk ka kosto
18. Thellimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit,	18.1 Nënshkrimi dhe verifikimi i funksionimit të	DPPPP DPSH PP	Në vazhdimësi	Nuk ka kosto



si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të terrorizmit.	marrëveshjes së bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore dhe në vijimësi ato ndërkombëtare. 18.2 Aksesimi nga ana e DPPP-së në bazën e të dhënave dhe informacione të tjera dhe regjistra publik sipas përcaktimeve të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008.	DPT DPD ZQRPP SHISH DPSHTRR	2011	
19. Kryerjen e analizave të përbashkëta midis institucioneve të gjurmimit, hetimit e gjykimit lidhur me grupet kriminale të hetuara e gjykuara për krime të organizuara e terrorizëm, në funksion të marrjes së masave parandaluese	19.1 Përveç analizave rast pas rasti mes institucioneve të hetimit dhe gjurmimit të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit, mënyrë veprimi do të jetë edhe kryerja e një analize njëvjeçare në funksion të këtij objekti, në të cilën përveç analizimit të arrietjeve të periudhës pararendëse përcaktohen objektiva të qarta për periudhën në vijim.	DPPP SHISH PP DPSH DPD DPT ZQRPP	Në vazhdim	Nuk ka kosto
20. Përfundimin e sistemeve të TI për transmetimin e analizave të informacionit që bën fjalë për vepra penale të krimit të terrorizmit.	20.1 Implementimi i softit analitik të disenjuar për detektimin e rasteve me risk. 20.2 Trajnimi i punonjësve përgjegjës të DPPP për përdorimin me efikasitet të mundësive që ofron ky soft.	DPPP	Dhjetor 2011 Në vazhdimësi	Mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Brendshme 1 000 000
21. Realizimi i një sistemi të plotë të informimit për tentativë të pastrimit të parave nga subjekte apo individë të dyshuar për terrorizëm.	21.1 Mundësimi i raportimit online të RTV dhe RAD, nga bankat e nivelit të dytë, noterët dhe disa subjekteve të tjera sipas kërkesave të ligjit të ri nr.9917 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. 21.2 Krijimi i aksesit për Policinë e Shtetit dhe prokurorinë në bazën e të dhënave që ka DPPP, në lidhje	DPPP PP,DPPSH	Dhjetor 2011 Viti 2011	DPPP 960 000

	me transaksionet e dyshimta.			
22. Paraqitja e strukturave të shtetit shqiptar si partnerë të aftë profesionalisht të barabartë dhe të besueshëm për strukturat homologe të vendeve të tjera.	22.1 Pjesëmarrja në projekte rajonale e më gjerë për parandalimin e radikalizmit apo ekstremizmit, si dhe të financimit të terrorizmit. 22.2 Rritja e shkëmbimit të informacionit me struktura homologe të vendeve të tjera.	DPPPP	Në vazhdimësi	Mbulohet nga buxheti i M.Brendshme 500 000
23. Realizimin e trajnimeve të vazhdueshme profesionale për punonjësit e shërbimit doganor.	23.1 Planifikimi dhe bashkëveprimi i strukturave të DP. të doganave për realizimin e trajnimeve të personelit doganor.	DP Doganave/DP Policisë Programi EXBS-Ambasada e SHBA-së	Në vazhdim	Burime të veta, si dhe financime të programit EXBS/Ambasada e SHBA USD-financime të njohura vetëm nga donator
24. Objektiva afatmesëm (2011-2013). Realizimin e një kontrolli të kufirit shtetëror, duke iu përafuar standardeve të vendeve të BE-së	24.1 Ndjekja në vijimësi e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë kundër terrorizmit.	Ministria e Financave DP Doganave DP Policisë	Në vazhdim	Kosto administrative
25. Thellimin e bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit, si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të terrorizmit.	25.1 Bashkëhartimi dhe nënshkrimi i memorandumëve të bashkëpunimit me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit dhe vijimi i bashkëpunimit me administratat doganore të vendeve kufitare, si dhe me projekte zhvillimi e organizma ndërkombëtarë	DP Doganave	Në vazhdim	Kosto administrative Eurofinancime të njohura vetëm nga institute partnere
26. Objektiva afatgjatë (2011 - 2015)	26.1 Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit. 26.2 Realizimi i masave të përshtatshme dhe në linjë me praktikat më të mira ndërkombëtare për parandalimin e veprimtarisë dhe akteve terroriste, duke arritur në standardet e vendeve më të zhvilluara në këtë drejtim.	Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Mbrojtjes, SHISH etj.	Në vijimësi	Burimet e veta, kontribute nga projektet e binjakëzimit që asistojnë strukturat shqiptare të zbatimit të ligjit eurofinancime të njohura nga donatorët
27. Paraqitja e strukturave të shtetit shqiptar si partnerë të aftë profesionalisht të	27.1 Rritja e bashkëpunimit dhe kontributit për forcimin	Ministria e Brendshme Ministria e	Në vazhdim	Burime të veta, si dhe financime të SECI-t dhe TAIEK-it euro-financime



barabartë dhe të besueshëm për homologët e vendeve të tjera	e qendrës SECI dhe shndërrimin e saj në organizatë ndërkombëtare 27.2 Themelimi i bashkëpunimit ndërmjet strukturave kompetente vendase dhe homologe të vendeve të rajonit e gjerë	Financave		të njohura vetëm nga donatorët
28. Forcimi i kapaciteteve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.	28.1 Draftimi i ligjit të ri për organizimin dhe funksionimin e AAPSK. 28.2 Rritja e kapacitetit teknik të stafit të AAPSK nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të specializuara. 28.3 Hartimi dhe miratimi i procedurave standarde të punës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara që rrjedhin nga terrorizmi.	Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme OPDAT, EURALIUS, DKE. Ministria e Financave AAPSK, MB, OPDAT dhe DKE Ministria e Financave AAPSK, Ministria e Brendshme	Në vazhdim Në vazhdimësi	Mbulohet nga buxheti i institucioneve. Për trajnimin e stafit do të përdoren fonde dhe ekspertiza e misionëve OPDAT dhe DKE.
29. Informimi në kohë për indikacione mbi veprimtari terroriste, trafike apo rrjete të krimit të organizuar, që mund të kërcënojnë sigurinë kombëtare dhe atë të Forcave të Armatosura.	29.1 Përmirësimi i teknikave të grumbullimit të informacionit për shkëmbimin në kohë të tij. 29.2 Grumbullim informacioni duke përdorur me efikasitet strukturat përkatëse të nivelit taktik dhe operacional. 29.3 Vlerësimi i rreziqeve dhe kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë fizike, sigurisë së personelit, sigurisë së informacionit të klasifikuar shtetëror dhe të NATO-s, si dhe sigurisë së operacioneve që kryejnë njësitë/repartet e Forcave të Armatosura. 29.4 Ndjekja e procesit të demontimit dhe asgjësimit të armatimit	Shërbimi Informativ Ushtarak, Policia Ushtarake Drejtoria e Zbulimit Ushtarak, Policia Ushtarake Drejtoria e Zbulimit Shërbimi informativ Ushtarak, Policia Ushtarake Drejtoria e Zbulimit Shtabi i Përgjithshëm komanda e forcave, Shërbimi Informativ Ushtarak, Policia Ushtarake Shërbimi	E përhershme E përhershme E përhershme E përhershme	Mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Buxheti vjetor SHIU. 3 000 000 5 000 000 5 000 000 Buxheti i Ministrisë së

	të municioneve të tepërta dhe të rrezikshme të Forcave të Armatosura, informimi për akte të mundshme terroriste apo përfshirje në trafike gjatë procesit. 29.5 Informim për dobësi të mundshme në sistemin e sigurisë fizike dhe industriale gjatë procesit të demontimit dhe asgjësimit të municioneve. 29.6 Zbatimi i procedurave për certifikimin e personelit civil dhe ushtarak të MM dhe FA që ka të drejtën për t'u njohur me informacionin e klasifikuar shtetëror dhe të NATO-s, si dhe për certifikimin e subjekteve juridike e fizike që veprojnë në cilësinë e kontraktorit apo nënkontraktorit me MM, FA, industrinë ushtarake etj.	informativ Ushtarak, Policia Ushtarake, Drejtoria e Zbulimit Shërbimi Informativ Ushtarak, Drejtoria e Zbulimit		Mbrojtjes dhe mbështetje nga vendet anëtare të NATO-s
30 . Përfshirja e kërcënimeve dhe rreziqeve të përcaktuara si prioritetet i veprimtarisë informative të SHIU-t	30.1 Përcaktimi i kërkesave për grumbullim informacioni dhe përfshirja e kërcënimeve dhe rreziqeve të përcaktuara në pikën 1 në kërkesat prioritare për inteligjencë të SHIU-t, miratimi i tyre nga Ministri i Mbrojtjes.	SHIU	Në vazhdim	Mbulohet nga buxheti vjetor i SHIU, kosto administrative
31. Shkëmbimi i informacionit sipas marrëveshjeve përkatëse me strukturat e tjera brenda e jashtë vendit të përfshira në luftën kundër terrorizmit e krimit të organizuar.	31.1 Përgatitja dhe miratimi i një plani bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Informativ Ushtarak, Drejtorisë së Zbulimit, Qendrës së Zbulimit Radioteknik dhe Policisë Ushtarake 31.2 Përgatitja dhe miratimi i një memorandumi bashkëpunimi ndërinstitucional me	SHIU, Drejtoria e Zbulimit, Policia Ushtarake, Qendra e Zbulimit Radioteknik SHIU në bashkëpunimin me SHISH, Policinë e Shtetit etj. Shërbimi	Në vazhdim Sipas planeve të përbashkëta	Kosto administrative e institucioneve



	strukturat e SHISH, Policisë së Shtetit etj. 31.3 Bashkëpunim me strukturat respektive të NATO-s. 31.4 Bashkëpunim me struktura respektive të shërbimeve të vendeve aleate e partnere. 31.5 Kryerja e operacioneve të përbashkëta me partnerë strategjikë. 31.6 Monitorimi i pandërprerë i hapësirës detare dhe shkëmbimi i informacionit me institucionet e tjera që kanë interesa në det (Kapitanerinë e Porteve, Policinë Kufitare, Inspektoratet e Peshkimit, Autoritetet Doganore, Antikontrabanda Detare etj.). 31.7 Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja Rrjeti Ndërrajonal Detar “Trans Regjional Maritime Network”. 31.8 Shkëmbimi i informacionit me Qendrën Operacionale në Romë sipas Marrëveshjes V-RMTC. 31.9 Vënia në funksionimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare.	informativ Ushtarak, Shtabi i Përgjithshëm SHIU, Drejtoria e Zbulimit SHIU Komanda e Forcave Ajrore Komanda e Forca Detare Komanda e Forcave Detare	Sipas marrëveshjeve Detyrë e përhershme Në vazhdim	Buxheti i institucioneve të tjera i papërcaktuar
32. Krijimi i një strukture të integruar të SHIU-t, Zbulimit Ushtarak dhe Qendrës së Zbulimit Radioteknik.	32.1 Përgatitja e draftprojektit të strukturës së integruar dhe miratimi nga Ministri i Mbrojtjes. 32.2 Vendosija e të gjitha aseteve grumbulluese të informacionit nën një strukturë të vetme. 32.3 Përmirësime ligjore dhe nënligjore. 32.4 Trajnim personeli	SHIU, Drejtoria e Zbulimit, Qendra e Zbulimit Radioteknik.	Në vazhdim	Kosto administrative

7599



	nevojshme. 34.6 Pajisja me anije të reja me kapacitete për luftë kundër terrorizmit. 34.7 Zhvillimi i stërvitjes dhe operacioneve të përbashkëta të anijeve të Rojës Bregdetare me institucionet e tjera (Forcat Ajrore, Policia Kufitare, Kapitaneria e Porteve, Antikontrabanda Detare etj.). 34.8 Pjesëmarrje në seminare, workshop dhe konferenca të organizuara rang kombëtar dhe ndërkombëtar për luftën kundër terrorizmit dhe krimet të organizuar. 34.9 Marrja në dorëzim dhe vënia në përdorim e sistemit të vëzhgimit të hapësirës detare. 34.10 Përpunimi i planeve operacionale dhe stërvitore për të siguruar mbështetjen e nevojshme të strukturave të tjera shtetërore në luftën kundër terrorizmit.	Shtabi i Përgjithshëm dhe SHIU, në bashkëpunim me strukturat e Ministrisë së Brendshme		
35. Bashkëpunimi stërvitor dhe operacional me organizmat ndërkombëtarë për luftën kundër terrorizmit.	35.1 Zhvillimi i stërvitjeve dhe operacioneve të përbashkëta rajonale dhe bilaterale me vendet partnere (iniciativa ADRION). 35.2 Pjesëmarrja në operacionin e NATO-s kundër terrorizmit detar. 35.3 Shkëmbimi i informacionit me Komandën e Komponentit Detar të Komandës së Forcave të Bashkuara të NATO-s Napoli. 35.4 Vijimi i	Komanda e Forcave Detare Komanda e Forcave Detare Shtabi i përgjithshëm, SHIU	E përhershme	Ministria e Mbrojtjes, kosto administrative

	trajnimeve të personelit të Forcave të Armatosura, në bashkëpunim me vendet aleate e partnerë për pjesëmarrje të përbashkëta në operacionet kundër terrorizmit brenda e jashtë vendit.			
36 . Forcimi i kontrollit të kufijve nëpërmjet implementimit të strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit	36.1 Bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme në fushën e vizave, azilit dhe migracionit. 36.2 Ngritja e qendrës së mbyllur për emigrantët e parregullt. 36.3 Negocimi i marrëveshjeve të ripranimit, si dhe zbatimi i tyre.	Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme	Në vazhdim	Ministritë përkatëse Kosto administrative
37. Bashkëpunimi i institucioneve shqiptare me homologët e huaj dhe organizatat ndërkombëtare	37.1 MPJ shfrytëzon të gjitha rrugët e komunikimit me përfaqësitë e huaja diplomatike dhe konsullore. 37.2 Vendosija e kontakteve me partnerë të huaj që trajtojnë çështje të terrorizmit dhe bashkëpunimi me ta. 37.3 Kontributi në marrëveshje të bashkëpunimit dhe i akteve të tjera ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit.	Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme	Në vazhdim	Pa kosto
38. Rritja e bashkëpunimit mes institucioneve tona dhe ato ndërkombëtare	38.1 Nënshkrimi i protokolleve të bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar.	DPT	Në vazhdim	Pa kosto
39. Ngushtimi i boshllëkut tatimor nëpërmjet luftës së mashtrimit tatimor dhe evazionit fiskal.	39.1 Rritja e bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Policisë së Shtetit DPD, ILDKP etj.	Drejtoria e Hetimit Tatimor, DPT Institucione të tjera	2011-2013	Kosto administrative
40. Forcimi i kapaciteteve parandaluese në luftën kundër mashtrimit tatimor dhe evazionit fiskal.	40.1 Rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe forcimi i kapaciteteve parandaluese të evazionit fiskal.	Drejtoria e Hetimit Tatimor DPT Institucione të tjera	Në vazhdim	Kosto administrative



41. Hartimi dhe përjasja e legjislacionit sipas standardeve të BE-së në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme e terrorizmit, luftën kundër korrupsionit, si dhe akteve të tjera të funksionimit të strukturave që kanë përgjegjësi për këtë drejtim, bazuar në strategjitë e tjera, si dhe planet e veprimit.	41.1 Identifikimi i vazhdueshëm i problemeve ligjore gjatë aktivitetit hetimor me qëllim dhënien e propozimeve konkrete për të përmirësuar legjislacionin në fushën konkrete.	Sipas institucioneve	Në vazhdimësi	Pa kosto
42. Hartimi i të gjitha akteve të nevojshme që do të thellojnë bashkëpunimin me struktura homologe të vendeve të rajonit e më gjerë në luftën kundër krimit të terrorizmit.	42.1 Rritja e bashkëpunimit të agjencive të zbatimit të ligjit duke rritur shkëmbimin e informacionit apo hetimet paralele me vendet përkatëse për çështje të terrorizmit.	Prokuroria e Përgjithshme	Në vazhdim	Kosto administrative
43. Krijimi i një sistemi të informacionit brenda strukturave të përfshira në luftën kundër terrorizmit	43.1 Fillimi i hartimit të një projekti për krijimin e një sistemi të dhënash mbi informacionet e rrjedhura nga hetimi i të gjitha rasteve që lidhen me veprat penale, objekt i kësaj strategjie.	Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes SHISH, Sistemi i prokurorisë	2011-2013	Ministria e Brendshme 2 000 000
44. Përfundimi i sistemeve të TI që bën fjalë për transmetimin e informacionit për vepra penale të krimit të terrorizmit.	44.1 Zbatimi i projektit të menaxhimit të rasteve.	Sistemi i prokurorisë	2011-2013	Ministria e Brendshme brenda koston së pikës 43.
45. Zgjerimi i aplikimit të teknikave të reja të investigimit brenda kuadrit ligjor të luftës kundër terrorizmit.	45.1 Rritja e efikasitetit në hetim nëpërmjet përdorimit më të gjerë të metodave speciale të hetimit. 45.2 Trajnime të vazhdueshme të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore mbi krimin kundër terrorizmit. 45.3 Angazhimi i një numri sa më të gjerë personash në hetimin e rasteve konkrete.	Ministria e Brendshme. Sistemi i prokurorisë	Në vazhdim	Mbulohet nga buxheti i institucioneve, kosto administrative
46. Thellimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit, si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën	46.1 Vendosja e pikave të përhershme të kontaktit me institucionet brenda vendit, si dhe me ato	Prokuroria e Përgjithshme dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit	Në vazhdim	Pa kosto

terrorizmit.	homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të terrorizmit.			
47. Krijimi i strukturave sipas kërkesave apo të parashikuara në strategjitë e tjera, rishikimi i komiteteve, komisioneve, sekretarive apo çdo funksion tjetër i krijuar nga strategjitë sektoriale me qëllim zgjerimin e kompetencave apo funksionimin e tyre për gjithë drejtimet e luftës kundër terrorizmit	47.1 Konsolidimi i njësive speciale të luftës kundër radikalizmit dhe ekstremizmit, që në thelb prodhojnë terrorizëm.	Ministria e Brendshme	Në vazhdim	Mbulohet nga buxheti i Ministria e Brendshme e përfshirë në koston e pikës 7. 3

Shënim. Plani i veprimit i përgatitur nga SHISH do të jetë pjesë e këtij plani veprimi, por për shkak të karakterit të klasifikuar nuk bëhet publik.

UDHËZIM
Nr.39, datë 6.10.2011

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER SHKENCOR/MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2011-2012

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, “Master profesional”, për vitin akademik 2011-2012”, vendimit nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master shkencor/master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2011-2012”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga “Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”,

UDHËZOJ:

1. Pranimin e aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë, “Master profesional” dhe “Master shkencor/master i arteve të bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë.
2. Aplikantët fitues përzgjidhen nga institucionet publike të arsimit të lartë në bazë të kritereve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.
3. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimi dhe të regjistrimit të aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë, “Master profesional” dhe “Master shkencor/master i arteve të bukura”. Procesi të monitorohet nga rektoratet dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
4. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së aplikimit të kërkesave për kandidatët që dëshirojnë të vijnë në programet e studimit të ciklit të dytë



“Master profesional” dhe “Master shkencor/master i arteve të bukura”, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime të bëhen publike në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

5. Aplikimet për regjistrim në programet e studimit të ciklit të dytë, “Master profesional” dhe “Master shkencor/master i arteve të bukura”, të bëhet pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore, nga data 10.10.2011 deri në datë 15.10.2012, prej orës 08:00 deri në orën 18:00, ku kandidati duhet të paraqitet personalisht dhe të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve, të shoqëruar me listën origjinale të notave;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë) dhe fotokopje të tyre. Në dosje të mbahet fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 2500 lekë, paguar në “Postën Shqiptare”;

e) Deklaratë që vërteton se kandidati nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi të ciklit të dytë, “Master profesional” dhe “Master shkencor/master i arteve të bukura”, në institucionet e arsimit të lartë publik.

6. Pranë njëjësive kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë të ngrihen komisione *ad-hoc* sipas fushave përkatëse, për përzgjedhjen e aplikantëve fitues në përputhje me kriteret e pranimit të vendosura dhe të shpallura publikisht nga këto institucione.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njëjësive kryesore përkatëse, brenda orës 16.00 të datës 22.10.2011, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara sipas vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, “Master profesional”, për vitin akademik 2011-2012”, si dhe vendimit nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master shkencor/master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2011-2012”.

8. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 24.10.2011 deri në datën 28.10.2011 prej orës 08:00 deri në orën 18:00 pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t’u kthehen personave kundrejt kërkesës. Për regjistrimin, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të paraqesë në origjinal dokumentet sipas shkronjës “a” dhe “b” të pikës 5 të këtij udhëzimi.

9. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare origjinale me regjistrimet e kryera brenda datës 10.11.2010, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

10. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.41, datë 13.10.2011

PËR PROCEDURËN E KONKURRIMIT ME FORMULARIN A3 DHE REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.423, datë 8.6.2011 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2011-2012, si dhe tarifat e shkollimit”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”, si edhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2011-2012, sipas programeve përkatëse të studimit, maturanët/kandidatët që shpallen fitues nga rishpërndarja e kuotave të përcaktuara, pas përfundimit të regjistrimeve në të dyja fazat e raundit të parë të konkurrimit me formularin A2.

2. Maturanët/kandidatët do të aplikojnë vetëm për programet e studimit dhe kuotat e shpallura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në formularin A3.

3. Fituesit përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (Drejtoria e Pranimeve), në bazë të dy parimeve:

a) “Parimi i meritës” përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara nga secili maturant, përllëgojë këto mbi bazën e rezultateve të shkollës së mesme, provimeve të Maturës Shtetërore dhe për programe studimi që parashikojnë konkurse edhe pikëve të grumbulluara nga konkursi.

b) “Parimi i preferencës” pasqyrohet nëpërmjet përzgjedhjes së vullnetshme të jo më shumë se 10 preferencave në formularin A3 dhe shprehet nëpërmjet preferencës më të lartë të grupit të preferencave fituese.

4. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë maturanët/kandidatët, të cilët kanë plotësuar ose jo formularin A2 dhe:

a) Nuk kanë arritur të përfshihen në listat e fituesve të fazës së parë dhe të dytë të konkurrimit me formularin A2 dhe për rrjedhojë nuk janë regjistruar në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012;

b) Janë shpallur fitues në listën paraprake ose përfundimtare të garës me formularin A2 dhe nuk janë të regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012;

c) Rezultuan mbetës në sesionin e parë të provimeve të Maturës Shtetërore (qershor 2011) dhe arritën rezultate kaluese në provimet e vjeshtës (sesioni i dytë);

d) Janë regjistruar në sesionin e dytë të Maturës Shtetërore 2011 nëpërmjet plotësimit të formularit A1Z dhe rezultojnë kalues në të katër provimet.

5. Drejtoria e Pranimeve pranë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP) t’u shpërndajë DAR/ZA-ve formularin A3 nga data 16.10.2011 deri më datë 17.10.2011.

6. DAR/ZA-të të shpërndajnë formularin A3 në shkolla në datën 17.10.2011.



7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 4 duhet të tërheqin formularin A3 në shkollat respektive ku kanë tërhequr formularin A2 dhe ta kthejnë atë të plotësuar me preferencat e tyre brenda datës 20.10.2011.

8. Maturantët/kandidatët që nuk kanë plotësuar më parë formularin A2, e marrin formularin A3 pasi të bëjnë pagesën prej 2000 lekësh pranë zyrave të “Postës Shqiptare”. Për këtë kontigjent maturantët/kandidatët drejtoritë e shkollave i dorëzojnë mandatpagesat përkatëse, së bashku me formularët A3 në DAR/ZA.

9. Drejtoritë e shkollave t’i dorëzojnë formularët A3, të plotësuar dhe të paplotësuar me procesverbal pranë DAR-ZA-ve përgjegjëse brenda datës 21.10.2011.

10. DAR/ZA-të duhet t’i dërgojnë formularët A3 në Drejtorinë e Pranimeve pranë AKP-së nga data 22.10.2011 deri në datën 23.10.2011.

11. Më datë 22.10.2011 ora 10.00 do të zhvillohet testimi i gjuhës angleze në Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës për maturantët/kandidatët që kanë përzgjedhur në preferencat e tyre dy programet e studimit të FASTIP-it, përkatësisht për programin e studimit “Menaxhim Hoteleri Turizëm” me kod 259, si edhe për programin e studimit “Menaxhim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” me kod 260.

12. Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) i universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, të dërgojë në Drejtorinë e Pranimeve pranë AKP-së rezultatet e testimit deri më datë 24.10.2011 ora 16:00.

13. Institucionet publike të arsimit të lartë, në datën 28.10.2011, të shpallin në vende të dukshme, në mjediset e tyre, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të domosdoshme për regjistrim, si edhe të dhëna të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecursisë normale të procesit të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë.

14. Drejtoria e Pranimeve në AKP të përpunojë të dhënat e marra nga formularët A3 dhe në datën 31.10.2011 të shpallë listën përfundimtare të fituesve, të ndara sipas programeve përkatëse të studimit, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe sipas preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A3, në përputhje me kuotat e rishpërndara dhe njëkohësisht ta dorëzojë këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. MASH e publikon këtë listë në faqen zyrtare të internetit brenda kësaj date.

15. Drejtoria e Pranimeve në AKP të dërgojë, në datë 31.10.2011, në formë të shkruar dhe elektronike, listat përfundimtare të fituesve, sipas programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA-të. Këto institucione të afishojnë menjëherë listat në vende të dukshme në mjediset e tyre.

16. Regjistrimi i fituesve të bëhet pranë sekretarive mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë në datat 1 deri 4 nëntor 2011, nga ora 8:00 deri në orën 18:00. Për regjistrim, kandidati fitues duhet të dorëzojë dosjen individuale me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Diploma e Maturës Shtetërore, dëftesë pjekurie (në mungesë, listë notash me fotografi, të nënshkruar nga drejtori i shkollës dhe drejtori i drejtorisë arsimore rajonale/drejtori i zyrës arsimore, ose listë notash të lëshuar nga Arkivi i Shtetit);

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë), origjinalin dhe fotokopjen e tij. Në dosje të mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit, në mungesë të tyre dorëzohet certifikatë personale me fotografi;

c) Dy fotografi;

d) Mandatarkëtimi të tarifës së regjistrimit prej 1550 lekësh të lëshuar nga zyrat e “Postës Shqiptare”.

17. Sekretaria mësimore të pajisë kandidatin fitues me fletëregjistrimi, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit fitues, data dhe ora e regjistrimit. Fletëregjistrimi duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga titullari i institucionit publik të arsimit të lartë/i njësisë kryesore që kryen regjistrimin dhe nga kryesekretari mësimor.

18. Për maturanët/kandidatët që e kanë likuiduar tarifën e regjistrimit në një nga fazat e regjistrimit me formularin A2, nuk është e nevojshme të bëjnë pagesë të re. Tarifat e regjistrimit prej 1550 lekësh, e arkëtuar nga maturanët/kandidatët në fazat e mëparshme, të kalojë me xhirim nga llogaria e degës së thesarit ku institucioni publik i arsimit të lartë ka llogarinë buxhetore, në llogarinë e thesarit të institucionit tjetër publik të arsimit të lartë, në të cilin është realizuar regjistrimi përfundimtar i maturanëve/kandidatëve me formularin A3.

19. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pranimeve në AKP listat përfundimtare origjinale të përgatitura nga Drejtoria e Pranimeve, me regjistrimet e kryera, në formë të shkruar dhe elektronike, brenda datës 7.11.2011, ora 14.00.

20. Në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues me formularin A3, sipas modelit të dërguar nga AKP, studentët të regjistrohen në regjistrin bazë në përputhje me përcaktimet e udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit” dhe të urdhrit nr.150, datë 7.4.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për përcaktimin e kodit të regjistrave të studentëve në IAL.”.

21. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

22. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Agjencia Kombëtare e Provimeve, institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE (AKP)

A3 PRANIMET 2011 NË ARSIMIN E LARTË

përmes parimit Meritë - Preferencë

Potësoni Nolin Mesatare me numra dhe me fjalë

1		6	
2		7	
3		8	
4		9	
5		10	

Vendosni numrin e preferencës në krah të kodit të programit të studimit

UNIVERSITETI I TIRANËS

- 001 Histori (5)
- 002 Gjeografi (5)
- 003 Gjuhë - Letërsi (5)
- 005 Biologji (5)
- 008 Fizikë (15)
- 009 Informatikë (10)
- 010 Kimi (5)
- 011 Kimi Ushqimorë (5)
- 012 Kimi Industriale (5)
- 013 Inxhinieri Matematike dhe Informatike (10)
- 014 Teknologji Informacioni dhe komunikimi (10)
- 015 Gjuhë Angleze (10)
- 016 Gjuhë Frënge (10)
- 017 Gjuhë Gjermane (10)
- 018 Gjuhë Italiane (10)
- 019 Gjuhë Greke (10)
- 020 Gjuhë Turke (5)
- 021 Gjuhë Ruse (15)
- 022 Gjuhë Spanjolle (10)
- 024 Gjuhë Angleze (Filiali Sarandë) (15)
- 027 Filozofi (8)
- 035 Administrim - Biznes (Filiali Kukës) (20)
- 036 Administrim - Biznes (Filiali Sarandë) (30)
- 047 Infermieri e Përgjithshme (Filiali Kukës) (25)
- 048 Infermieri e Përgjithshme (Filiali Sarandë) (25)

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

- 050 Menaxhim Agrobiznesi (15)
- 051 Menaxhim Agrobiznesi (Filiali Lushnjë) (35)
- 052 Ekonomi dhe Politikë Agrare (15)
- 054 Finance - Kontabilitet (Filiali Lushnjë) (20)
- 055 Menaxhim i Turizmit Rural (20)
- 056 Mbrojtje Bimësh (10)
- 057 Hortikulturë (15)
- 058 Hortikulturë (Filiali Lushnjë) (30)
- 059 Prodhim Bimor (25)
- 060 Zooteknik dhe Biznes Blegtoral (20)
- 061 Akaakulturë dhe Menaxhim Peshkimi (20)
- 062 Agromjedis dhe Ekologji (10)
- 063 Agromekanizim (15)
- 064 Teknologji Agroushqimorë (20)
- 065 Vreshtari - Enologji (20)
- 066 Mbarështrim Pyjesh (15)
- 067 Përpunim Druri (20)
- 068 Mjekësi Veterinare (20)
- 069 Menaxhim Veterinar (Filiali Lushnjë, 2 vjeçar) (45)

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

- 075 Inxhinieri Gjeodet (10)
- 076 Inxhinieri Elektrike (Automatizim i Industrisë) (10)
- 078 Inxhinieri Mekanike (10)
- 079 Inxhinieri Fizike (10)
- 080 Inxhinieri Matematike (10)
- 081 Inxhinieri Mekanike (10)
- 082 Inxhinieri Tekstile dhe Mode (10)
- 083 Inxhinieri Materiale (10)
- 085 Inxhinieri Gjeologjike (10)
- 086 Inxhinieri Gjeoinformatike (10)
- 087 Inxhinieri e Burimeve Natyrore (15)

UNIVERSITETI I KORÇËS "Fan S. Noli"

- 091 Cikli i Ulet (10)
- 092 Cikli i Ulet Parashkollor (10)
- 093 Cikli i Ulet - Gjuhë Angleze (Filiali Pogradec) (15)
- 094 Gjuhë Angleze (10)
- 095 Filozofi - Sociologji (10)
- 096 Matematikë - Fizikë (30)
- 097 Matematikë - Informatikë (50)
- 098 Gjuhë - Letërsi (15)
- 099 Gjuhë Shqipe dhe Frënge (30)
- 100 Histori - Gjeografi (15)
- 101 Biologji - Kimi (30)
- 102 Teknologji informacioni (20)
- 103 Marketing (20)
- 104 Menaxhim (20)
- 105 Turizëm (30)
- 106 Turizëm (Filiali Pogradec) (20)
- 107 Finance-Kontabilitet (20)
- 108 Agrobiznes (15)
- 109 Hortikulturë (30)
- 110 Agroushqim (30)
- 111 Teknologji e Prodhimit Bimor (20)
- 113 Mami (Infermieri) (30)

UNIVERSITETI I ELBASANIT "Aleksandër Xhuvani"

- 114 Gjuhë - Letërsi (10)
- 115 Gjuhë Shqipe dhe Frënge (15)
- 116 Histori-Gjeografi (10)
- 117 Histori dhe Gjuhë Gjermane (15)
- 118 Gjeografi dhe Gjuhë Italiane (10)
- 119 Gjuhë Angleze (10)
- 120 Gjuhë Gjermane (30)
- 121 Gjuhë Frënge (30)
- 122 Gjuhë Italiane (10)
- 123 Gazetari (10)
- 124 Gazetari-Anglisht (20)
- 125 Biologji-Kimi (15)
- 126 Matematikë-Fizikë (20)

- 127 Teknologjite e Informatonit (30)
- 130 Teknologji laborant (2 vjeçar) (30)
- 131 Fizikë Kompjuterike (30)
- 132 Arsimi Fillor (10)
- 133 Arsimi Parashkollor (15)
- 134 Edukim Qytetar (15)
- 135 Punonjës Social (10)
- 136 Filozofi-Sociologji (10)
- 137 Psikologji (10)
- 139 Administrim-Biznes (10)
- 141 Ekonomia dhe e Drejtë (10)

UNIVERSITETI I GJIROKASTRËS "Eqrem Çabej"

- 143 Histori - Gjeografi (20)
- 144 Gjuhë-Letërsi Shqipe (32)
- 145 Administrim Publik (10)
- 146 Turizëm (40)
- 147 Kontabilitet - Finance (15)
- 148 Gjuhë Letërsi Angleze (20)
- 149 Gjuhë Letërsi Italiane (20)
- 150 Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek (20)
- 151 Mesuesi për Arsimin Fillor (20)
- 152 Mesuesi për Arsimin Parashkollor (20)
- 153 Matematikë-Fizikë (20)
- 154 Fizikë dhe Teknologji informacioni (80)
- 155 Teknologji informacioni (100)
- 156 Matematikë-Informatikë (100)
- 157 Biologji-Kimi (20)
- 158 Infermieri (35)

UN. I SHKODRËS "Luigj Gurakuqi"

- 159 Gjuhë - Letërsi (10)
- 160 Histori (10)
- 161 Gjeografi (5)
- 162 Gazetari dhe Komunikim (5)
- 163 Matematikë (10)
- 164 Fizikë (15)
- 165 Biologji-Kimi (10)
- 166 Informatikë (20)
- 167 Infermieri e Përgjithshme (20)
- 168 Infermieri (Mami) (20)
- 170 Administrim-Biznes (10)
- 172 Turizëm (10)
- 173 Gjuhë Angleze (10)
- 174 Gjuhë Italiane (10)
- 175 Gjuhë Gjermane (15)
- 176 Gjuhë Frënge (10)
- 177 Cikli i Ulet (10)
- 178 Cikli i Ulet Parashkollor (20)
- 180 Punë Sociale (10)
- 183 Drejtësi (15)

UNIVERSITETI I VLORËS "Ismail Qemali"

- 184 Gjuhë Letërsi (10)
- 185 Gjuhë Angleze (10)
- 186 Gjuhë Italiane (10)
- 187 Ciklet i Ulet (10)
- 188 Ciklet i Ulet Parashkollor (10)
- 189 Pedagogji e Specializuar (10)
- 190 Drejtësi (10)
- 191 Gjeografi - Histori (10)
- 192 Fizikë (30)
- 193 Biologji (30)
- 194 Kimi (20)
- 195 Aktuaristike (20)
- 196 Matematikë - Finance (40)
- 197 Informatikë (30)
- 198 Teknologji Informacioni (30)
- 199 Shkenca Kompjuterike (30)
- 200 Shkenca Kompjuterike (30)
- 201 Matematikë (50)
- 202 Matematikë - Fizikë (50)
- 203 Inxhinieri Navigacionale (10)
- 204 Peshkim Detar (30)
- 205 Inxhinieri Mekanike (5)
- 206 Inxhinieri Navale (10)
- 207 Inxhinieri Elektrike (10)
- 208 Administrim Biznesi (15)
- 209 Ekonomiks (10)
- 210 Finance (10)
- 211 Turizëm (20)
- 212 Marketing (30)
- 213 Kontabilitet (55)
- 214 Infermier Mami (30)
- 215 Infermier i Përgjithshëm (30)

UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu"

- 217 Menaxhim Marketing (10)
- 218 Shkenca Ekonomike (5)
- 220 Bankë - Finance (5)
- 221 Menaxhim Hotel Restorant (10)
- 222 Menaxhim Turizëm Kulturor (5)
- 223 Menaxhim Turizëm Arkeologjik (5)
- 224 Gjuhë Angleze (5)
- 225 Cikli i Ulet (5)
- 226 Ekspert në Proceset e Formimit (5)
- 228 Gjuhë-Letërsi-Anglisht (10)
- 230 Ndihmës Dentist (2 vjeçar) (10)
- 231 Menaxhim Nderimi (2 vjeçar) (10)
- 232 Menaxhim Transporti (2-vjeçar) (10)
- 233 Asistent Ligjor (2 vjeçar) (10)
- 234 Asistent Administrativ (2-vjeçar) (10)
- 235 Teknologji Automobilash (2-vjeçar) (10)

- 236 Specialist Rrjetesh Kompjuterike (2 vjeçar) (10)
- 237 Informatikë Praktike (2-vjeçar) (10)
- 238 Juridik (5)
- 239 Shkenca Politike (5)
- 240 Administrim Publik (5)
- 241 Shkenca Kompjuterike (10)
- 242 Sistemet e Informacionit (10)
- 246 Finance-Kontabilitet (Filiali Peshkopi) (5)
- 247 Informatikë-Anglisht (Filiali Peshkopi) (5)
- 248 Matematikë-Informatikë (Filiali Peshkopi) (10)
- 249 Biokimi (Filiali Peshkopi) (5)
- 250 Psikologji-Sociologji (Filiali Peshkopi) (5)
- 251 Ekspert Proces Formimi (Filiali Peshkopi) (5)
- 252 Finance-Bankë (Filiali Peshkopi) (5)
- 253 Menaxhim-Marketing (Filiali Peshkopi) (5)
- 254 Menaxhim-Biznes (Filiali Peshkopi) (5)
- 255 Administrim-Biznes (Filiali Peshkopi) (5)
- 256 Infermieri e Përgjithshme (Filiali Peshkopi) (5)
- 257 Matematikë-Fizikë (Filiali Peshkopi) (10)
- 259 * Menaxhim Hoteleri Turizëm (FASTIP) (30)
- 260 * Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (FASTIP) (30)

UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË

- 261 Regji filmi dhe TV (3)
- 266 Pikturë (8)
- 267 Skulpturë (2)
- 268 Muzikologji (1)
- 269 Kompozim (1)
- 270 Dirigjim (1)
- 272 Violinë (1)
- 275 Kitare (2)
- 279 Klarinetë (9)
- 281 Korno (1)
- 285 Këngëtar (2)
- 286 Pedagogji muzikore (3)
- 287 Fizarmonike Klasike (1)

UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

- 288 Shkenca të lëvizjes (15)
- 289 Fushat e vëprimit: fizike, të shëndetit dhe rekreacionit (15)

UNIVERSITETI I GJIROKASTRËS "Eqrem Çabej"

- 290 Histori dhe Gjuhë Italiane (59)

* Në këto programe studimi pranimi bëhet me test të njohurive të gjuhës angleze. Testi zhvillohet më datë 22.10.2011, ora 10.00, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.

UDHËZIM
Nr.42, datë 13.10.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.39, DATË 6.10.2011 TË MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE/ MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimiit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, “Master profesional”, për vitin akademik 2011-2012”, të vendimit nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimiit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave/master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2011-2012”, si dhe të vendimit nr.241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr.39, datë 6.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për procedurat e pranimiit dhe të regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave/master i arteve të bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012”, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master i shkencave/master i arteve të bukura” të bëhet pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, nga data 10.10.2011 deri në datën 30.10.2011, prej orës 08:00 deri në orën 18:00, ku kandidati duhet të paraqitet personalisht dhe të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve të shoqëruar me listën origjinale të notave;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë) dhe fotokopje të tyre. Në dosje të mbahet fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 2.500 lekë, paguar në Postën Shqiptare;

e) Deklaratë që vërteton se kandidati nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi të ciklit të dytë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave/master i arteve të bukura”, në institucionet e arsimit të lartë publik.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16.00 të datës 4.11.2011, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara sipas vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimiit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, “Master profesional”, për vitin



akademik 2011-2012”, të vendimit nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave/master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2011-2012”.

3. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 7.11.2011 deri në datën 10.11.2011 prej orës 08:00 deri në orën 18:00 pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jo fitues t’u kthehen personave kundrejt kërkesës. Për regjistrimin kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të paraqesë në origjinal dokumentet sipas shkronjës “a” dhe “b” të pikës 5 të udhëzimit.

II. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.44, datë 3.11.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.19, DATË 18.7.2007 “PËR
GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 58 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pas pikës 2 të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit” shtohet pika 2.1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“2.1 Institucionet e arsimit të lartë i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), listën e studentëve të regjistruar në vitin akademik përkatës, në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD), sipas afatit të përcaktuar në udhëzimin respektiv për regjistrimet. AKP brenda 1 muaji i dërgon institucioneve të arsimit të lartë, listën përkatëse të numrave të matrikullimit për çdo student.”

2. Pika 13 e udhëzimit ndryshon, si më poshtë vijon:

“13. Agjencia Kombëtare e Provimeve në bashkëpunim me sektorin e statistikave në MASH përgatit Rregulloren teknike të administrimit dhe sigurisë së bazës shtetërore (kombëtare) të të dhënave të studentëve.”

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.511, datë 13.10.2011

**PËR RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA NË FAZËN E DYTË TË
KONKURRIMIT ME FORMULARIN A2, TË PRANIMEVE NË CIKLIN E PARË TË
STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012, NËPËRMJET FORMULARIT A3**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2077 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.423, datë 8.6.2011 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2011-2012, si dhe tarifat e shkollimit”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”, si edhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kuotat e parealizuara, pas mbylljes së fazës përfundimtare të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë për vitin akademik 2011-2012 (raundi i parë i konkurrimit me formularin A2), të shpërndahen sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur.

2. Plotësimin e formularit A3 nga maturantët/kandidatët, të cilët:

a) Nuk kanë arritur të përfshihen në listat e fituesve të fazës së parë dhe të dytë të konkurrimit me formularin A2, dhe për rrjedhojë nuk janë regjistruar në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012;

b) Janë shpallur fitues në listën paraprake ose përfundimtare të garës me formularin A2 dhe nuk janë të regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012;

c) Rezultuan mbetës në sesionin e parë të provimeve të Maturës Shtetërore (qershor 2011) dhe arritën rezultate kaluese në provimet e vjeshtës (sesioni i dytë);

d) Janë regjistruar në sesionin e dytë të Maturës Shtetërore 2011 nëpërmjet plotësimit të formularit A1Z dhe rezultojnë kalues në të katër provimet.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), DAR/ZA-të dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



TABELA NR.1
LISTA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE KUOTAVE PËRKATËSE TË
FORMULARIT A3

Nr.	Universitetet	ID Dega	Emërtimi i degës	Kuota Formulari A3
1	UT	001	Histori	5
2	UT	002	Gjeografi	5
3	UT	003	Gjuhë-letërsi	5
4	UT	005	Biologji	5
5	UT	008	Fizikë	15
6	UT	009	Informatikë	10
7	UT	010	Kimi	5
8	UT	011	Kimi ushqimore	5
9	UT	012	Kimi industriale	5
10	UT	013	Inxhinieri matematike dhe informatike	10
11	UT	014	Teknologji informacioni dhe komunikimi	10
12	UT	015	Gjuhë angleze	10
13	UT	016	Gjuhë frënge	10
14	UT	017	Gjuhë gjermane	10
15	UT	018	Gjuhë italiane	10
16	UT	019	Gjuhë greke	10
17	UT	020	Gjuhë turke	5
18	UT	021	Gjuhë ruse	15
19	UT	022	Gjuhë spanjolle	10
20	UT	024	Gjuhë angleze (filiali Sarandë)	15
21	UT	027	Filozofi	8
22	UT	035	Administrim-biznes (filiali Kukës)	20
23	UT	036	Administrim-biznes (filiali Sarandë)	30
24	UT	047	Infermieri e përgjithshme (filiali Kukës)	25
25	UT	048	Infermieri e përgjithshme (filiali Sarandë)	25
26	UBT	050	Menaxhim agrobiznesi	15
27	UBT	051	Menaxhim agrobiznesi (filiali Lushnjë)	35
28	UBT	052	Ekonomi dhe politikë agrare	15
29	UBT	054	Financë-kontabilitet (filiali Lushnjë)	20
30	UBT	055	Menaxhim i turizmit rural	20
31	UBT	056	Mbrojtje bimësh	10
32	UBT	057	Hortikulturë	15
33	UBT	058	Hortikulturë (filiali Lushnjë)	30
34	UBT	059	Prodhim bimor	25
35	UBT	060	Zooteknë dhe biznes blegtoral	20
36	UBT	061	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi	20
37	UBT	062	Agromjedis dhe ekologji	10
38	UBT	063	Agromekanizim	15
39	UBT	064	Teknologji agroushqimore	20
40	UBT	065	Vreshtari-enologji	20
41	UBT	066	Mbarështrim pyjesh	15
42	UBT	067	Përpunim druri	20
43	UBT	068	Mjekësi veterinarë	20
44	UBT	069	Menaxhim veterinar (filiali Lushnjë, 2-vjeçar)	45
45	UPT	075	Inxhinieri gjeodet	10
46	UPT	076	Inxhinieri elektrike (automatizim i industrisë)	10
47	UPT	078	Inxhinieri mekatronike	10
48	UPT	079	Inxhinieri fizike	10

49	UPT	080	Inxhinieri matematike	10
50	UPT	081	Inxhinieri mekanime	10
51	UPT	082	Inxhinieri tekstile dhe mode	10
52	UPT	083	Inxhinieri materiale	10
53	UPT	085	Inxhinieri gjeologjike	10
54	UPT	086	Inxhinieri gjeoinformatike	10
55	UPT	087	Inxhinieri e burimeve natyrore	15
56	UK	091	Cikli i ulët	10
57	UK	092	Cikli i ulët parashkollor	10
58	UK	093	Cikli i ulët-Gjuhë angleze (filiali Pogradec)	15
59	UK	094	Gjuhë angleze	10
60	UK	095	Filozofi-sociologji	10
61	UK	096	Matematikë-fizikë	30
62	UK	097	Matematikë-informatikë	50
63	UK	098	Gjuhë-letërsi	15
64	UK	099	Gjuhë shqipe dhe frënge	30
65	UK	100	Histori-gjeografi	15
66	UK	101	Biologji-kimi	30
67	UK	102	Teknologji informacioni	20
68	UK	103	Marketing	20
69	UK	104	Menaxhim	20
70	UK	105	Turizëm	30
71	UK	106	Turizëm (filiali Pogradec)	20
72	UK	107	Financë-kontabilitet	20
73	UK	108	Agrobiznes	15
74	UK	109	Hortikulturë	30
75	UK	110	Agroushqim	30
76	UK	111	Teknologji e prodhimit bimor	20
77	UK	113	Mami (infermier)	30
78	UE	114	Gjuhë-letërsi	10
79	UE	115	Gjuhë shqipe dhe frënge	15
80	UE	116	Histori-gjeografi	10
81	UE	117	Histori dhe Gjuhë gjermane	15
82	UE	118	Gjeografi dhe Gjuhë italiane	10
83	UE	119	Gjuhë angleze	10
84	UE	120	Gjuhë gjermane	30
85	UE	121	Gjuhë frënge	30
86	UE	122	Gjuhë italiane	10
87	UE	123	Gazetari	10
88	UE	124	Gazetari-anglisht	20
89	UE	125	Biologji-kimi	15
90	UE	126	Matematikë-fizikë	20
91	UE	127	Teknologjitë e informacionit	30
92	UE	130	Teknolog laborant (2-vjeçar)	30
93	UE	131	Fizikë kompjuterike	30
94	UE	132	Arsimi fillor	10
95	UE	133	Arsimi parashkollor	15
96	UE	134	Edukim qytetar	15
97	UE	135	Punonjës social	10
98	UE	136	Filozofi-sociologji	10
99	UE	137	Psikologji	10
100	UE	139	Administrim-biznes	10
101	UE	141	Ekonomia dhe e drejta	10
102	UGJ	143	Histori-gjeografi	20
103	UGJ	144	Gjuhë-letërsi shqipe	32
104	UGJ	145	Administrim publik	10



105	UGJ	146	Turizëm	40
106	UGJ	147	Kontabilitet-financë	15
107	UGJ	148	Gjuhë-letërsi angleze	20
108	UGJ	149	Gjuhë-letërsi italiane	20
109	UGJ	150	Gjuhë-letërsi dhe Qytetërim Grek	20
110	UGJ	151	Mësuesi për arsimin fillor	20
111	UGJ	152	Mësuesi për arsimin parashkollor	20
112	UGJ	153	Matematikë-fizikë	20
113	UGJ	154	Fizikë dhe Teknologji informacioni	80
114	UGJ	155	Teknologji informacioni	100
115	UGJ	156	Matematikë-informatikë	100
116	UGJ	157	Biologji-kimi	20
117	UGJ	158	Infermieri	35
118	USH	159	Gjuhë-letërsi	10
119	USH	160	Histori	10
120	USH	161	Gjeografi	5
121	USH	162	Gazetari dhe komunikim	5
122	USH	163	Matematikë	10
123	USH	164	Fizikë	15
124	USH	165	Biologji-kimi	10
125	USH	166	Informatikë	20
126	USH	167	Infermieri e përgjithshme	20
127	USH	168	Infermieri (mami)	20
128	USH	170	Administrim-biznes	10
129	USH	172	Turizëm	10
130	USH	173	Gjuhë angleze	10
131	USH	174	Gjuhë italiane	10
132	USH	175	Gjuhë gjermane	15
133	USH	176	Gjuhë frënge	10
134	USH	177	Cikli i ulët	10
135	USH	178	Cikli i ulët parashkollor	20
136	USH	180	Punë sociale	10
137	USH	183	Drejtësi	15
138	UV	184	Gjuhë letërsi	10
139	UV	185	Gjuhë angleze	10
140	UV	186	Gjuhë italiane	10
141	UV	187	Cikli i ulët	10
142	UV	188	Cikli i ulët parashkollor	10
143	UV	189	Pedagogji e specializuar	10
144	UV	190	Drejtësi	10
145	UV	191	Gjeografi-histori	10
146	UV	192	Fizikë	30
147	UV	193	Biologji	30
148	UV	194	Kimi	20
149	UV	195	Aktuaristikë	20
150	UV	196	Matematikë-financë	40
151	UV	197	Informatikë	30
152	UV	198	Teknologji informacioni	30
153	UV	199	Shkenca kompjutacionale	30
154	UV	200	Shkenca kompjuterike	30
155	UV	201	Matematikë	50
156	UV	202	Matematikë-fizikë	50
157	UV	203	Inxhinieri navigacionale	10
158	UV	204	Peshkim detar	30
159	UV	205	Inxhinieri mekanike	5

160	UV	206	Inxhinieri navale	10
161	UV	207	Inxhinieri elektrike	10
162	UV	208	Administrim biznesi	15
163	UV	209	Ekonomiks	10
164	UV	210	Financë	10
165	UV	211	Turizëm	20
166	UV	212	Marketing	30
167	UV	213	Kontabilitet	55
168	UV	214	Infermier mami	30
169	UV	215	Infermier i përgjithshëm	30
170	UD	217	Menaxhim marketing	10
171	UD	218	Shkenca ekonomike	5
172	UD	220	Bankë-financë	5
173	UD	221	Menaxhim hotel restorant	10
174	UD	222	Menaxhim turizëm kulturor	5
175	UD	223	Menaxhim turizëm arkeologjik	5
176	UD	224	Gjuhë angleze	5
177	UD	225	Cikli i ulët	5
178	UD	226	Ekspert në proceset e formimit	5
179	UD	228	Gjuhë-letërsi-anglisht	10
180	UD	230	Ndihmës dentist (2-vjeçar)	10
181	UD	231	Menaxhim ndërtimi (2-vjeçar)	10
182	UD	232	Menaxhim transporti (2-vjeçar)	10
183	UD	233	Asistent ligjor (2-vjeçar)	10
184	UD	234	Asistent administrativ (2-vjeçar)	10
185	UD	235	Teknologji automobilash (2-vjeçar)	10
186	UD	236	Specialist rrjetesh kompjuterike (2-vjeçar)	10
187	UD	237	Informatikë praktike (2-vjeçar)	10
188	UD	238	Juridik	5
189	UD	239	Shkenca politike	5
190	UD	240	Administrim publik	5
191	UD	241	Shkenca kompjuterike	10
192	UD	242	Sistemet e informacionit	10
193	UD	246	Financë-kontabilitet (filiali Peshkopi)	5
194	UD	247	Informatikë anglisht (filiali Peshkopi)	5
195	UD	248	Matematikë-informatikë (filiali Peshkopi)	10
196	UD	249	Biokimi (filiali Peshkopi)	5
197	UD	250	Psikologji-sociologji (filiali Peshkopi)	5
198	UD	251	Ekspert proces formimi (filiali Peshkopi)	5
199	UD	252	Financë-bankë (filiali Peshkopi)	5
200	UD	254	Menaxhim-marketing (filiali Peshkopi)	5
201	UD	255	Administrim-biznesi (filiali Peshkopi)	5
202	UD	256	Infermieri e përgjithshme (filiali Peshkopi)	5
203	UD	257	Matematikë-fizikë (filiali Peshkopi)	10
204	UD	259	Menaxhim hoteleri turizëm (FASTIP)	30
205	UD	260	Menaxhim i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (FASTIP)	30
206	UAT	261	Regji filmi dhe TV	3
207	UAT	266	Pikturë	8
208	UAT	267	Skulpturë	2
209	UAT	268	Muzikologji	1
210	UAT	269	Kompozim	1
211	UAT	270	Dirigjim	1
212	UAT	272	Violinë	1
213	UAT	275	Kitarë	2
214	UAT	279	Klarinetë	9
215	UAT	281	Korno	1



216	UAT	285	Këngëtar	2
217	UAT	286	Pedagogji muzikore	3
218	UAT	287	Fizarmonikë klasike	1
219	UST	288	Shkenca të lëvizjes	15
220	UST	289	Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe rekreacionit	15
221	UGJ	290	Histori dhe gjuhë italiane	59

URDHËR

Nr.528, datë 25.10.2011

PËR TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, MË KOHË TË PJESSHME E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr.8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politike nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, si dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit” dhe pikës 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.627, datë 31.8.2011 “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifën e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2011-2012”,

URDHËROJME:

1. Tarifa për kreditë e shkollimit, për ata që kryejnë një program të parë studimi, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë, të jetë sipas kolonës F të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Tarifa totale e shkollimit (180 kredite), për ata që kryejnë një program të parë studimi, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë të jetë sipas kolonës G të tabelës nr.1 bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Tarifa për kreditë e shkollimit, për ata që kryejnë një program të dytë studimi, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë të jetë sipas kolonës H të tabelës nr.1.

4. Tarifa totale e shkollimit (180 kredite), për ata që kryejnë një program të dytë studimi, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë të jetë sipas kolonës I të tabelës nr.1.

5. Tarifa e shkollimit paguhet me këste vjetore, çdo fillim viti akademik, të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë sipas përcaktimeve në rregulloret e tyre.

6. Studentët e shpallur jokalues/përsëritës, paguajnë tarifë shkollimi, në vitin përsëritës, vetëm për kreditet e provimeve të mbartura.

7. Kandidatët që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012 dhe që u përkasin shtresave sociale, si: personave që nuk shikojnë dhe që nuk dëgjojnë, invalidë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijë romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve dhe ushtarakëve të rënë për shkak të detyrës e të ish-të përndjekurve politikë, paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit. Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave sociale.

8. Tarifat e shkollimit të llogaritura sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, paguhen pranë zyrave të “Postës Shqiptare”, për llogari të institucionit të arsimit të lartë publik përkatës.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode



TABELA Nr.1

TARIFAT CIKEL I PARË, KOHË E PJESSHME DHE EDUKIM NË DISTANCË 2011-2012

A	B	C	F	G	H	I
K_UNIVERSITETI	K_ID_P ROGRA MIT	K_EMËRTIMI_PROGRAMIT	Tarifa për Kredit, Prog. Parë (në lekë)	Tarifa Totale Prog. Parë 2011-2012 (në lekë)	Tarifa për Kredit, Prog. Dytë (në lekë)	Tarifa Totale Prog. Dytë 2011-2012 (në lekë)
Universiteti i Tiranës	1	Histori	884	159,120	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	2	Gjeografi	884	159,120	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	3	Gjuhë-Letersi	884	159,120	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	4	Biologji	954	171,662	1,352	243,360
Universiteti i Tiranës	5	Punë Sociale	884	159,120	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	6	Psikologji	884	159,120	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	7	Sociologji	884	159,120	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	8	Drejtesi	572	102,960	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	9	Infermieri e Përgjithshme	954	171,662	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	10	Mami	954	171,662	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	11	Teknik i Lartë Laboratori	954	171,662	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	12	Fizioterapi	954	171,662	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	13	Imazheri	954	171,662	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	14	Administrim -Biznes	780	140,400	1,560	280,800
Universiteti i Tiranës	15	Financë-Kontabilitet	780	140,400	1,560	280,800
Univ. Bujqësor i Tiranës	16	Prodhim Bimor	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Bujqësor i Tiranës	17	Agromekanizim	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Bujqësor i Tiranës	18	Zootekni dhe Biznes Blegtoral	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Bujqësor i Tiranës	19	Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Bujqësor i Tiranës	20	Hortikulturë	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Bujqësor i Tiranës	21	Mbrojtje Bimësh	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Bujqësor i Tiranës	22	Agromjedis dhe Ekologji	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Bujqësor i Tiranës	23	Drejtim Agrobiznesi	780	140,400	884	159,120
Univ. Bujqësor i Tiranës	24	Ekonomi dhe Politikë Agrare	780	140,400	884	159,120
Univ. Bujqësor i Tiranës	25	Financë-Kontabilitet	780	140,400	884	159,120
Univ. Bujqësor i Tiranës	26	Teknologji Agroushqimore	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Bujqësor i Tiranës	27	Vreshtari-Enologji	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Bujqësor i Tiranës	28	Mbarështrim-Shfrytezim	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Bujqësor i Tiranës	29	Përpunim Druri	728	131,040	1,352	243,360
Univ. Politeknik i Tiranës	30	Inxhinieri Logjistike Prodhimi	1,872	336,960	2,080	374,400
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	31	Gjuhë-Letersi	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	32	Cikël i Ulët	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	33	Cikël i Ulët Parashkollor	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	34	Financë-Kontabilitet	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	35	Menaxhim	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	36	Marketing	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	37	Turizëm	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	38	Turizëm (Filiali Pogradec)	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	39	Agroushqim	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	40	Agrobiznes	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	41	Hortikulturë	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	42	Infermieri e Përgjithshme	954	171,662	1,144	205,920
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	43	Matematikë-Fizikë	624	112,320	1,144	205,920
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	44	Biologji-Kimi	954	171,662	1,144	205,920
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	45	Teknologji Informacioni	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	46	Infermieri e Përgjithshme	954	171,662	1,144	205,920
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	47	Administrim -Biznes	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	48	Financë-Kontabilitet	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	49	Ekonomia dhe e Drejta	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	50	Arsimi Fillor	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	51	Arsimi Parashkollor	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	52	Edukatë qytetare	884	159,120	1,144	205,920

Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	53	Punë Sociale	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	54	Filozofi-Sociologji	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	55	Gjuhë-Letërsi	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "A.Xhuvani" Elbasan	56	Histori-Gjeografi	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	57	Matematikë-Fizikë	624	112,320	1,144	205,920
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	58	Biologji-Kimi	954	171,662	1,144	205,920
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	59	Histori-Gjeografi	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	60	Gjuhë-Letërsi Shqipe	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	61	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	62	Mësuesi për Arsimin Fillor	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	63	Kontabilitet-Financë	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	64	Administrim Publik	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "E.Çabej" Gjirokastrë	65	Turizëm	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	66	Fizikë	624	112,320	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	67	Biologji-Kimi	954	171,662	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	68	Gjuhë-Letërsi	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	69	Histori	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	70	Gjeografi	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	71	Cikël i Ulët	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	72	Cikël i Ulët Parashkollor	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	73	Financë-Kontabilitet	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	74	Administrim -Biznes	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	75	Turizëm	780	140,400	1,144	205,920
Univ. "L.Gurakuqi" Shkodër	76	Juridik	572	102,960	1,144	205,920
Univ. "A. Moisiu" Durrës	77	Administrim Biznesi	858	154,440	1,144	205,920
Univ. "A. Moisiu" Durrës	78	Financë-Kontabilitet	858	154,440	1,144	205,920
Univ. "A. Moisiu" Durrës	79	Cikël i Ulët	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "A. Moisiu" Durrës	80	Psikologji-Sociologji	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "A. Moisiu" Durrës	81	Infermieri e Përgjithshme	954	171,662	1,144	205,920
Univ. "A. Moisiu" Durrës	82	Drejtësi	572	102,960	1,144	205,920
Univ. "A. Moisiu" Durrës (Filiali Peshkopi)	83	Cikël i Ulët	884	159,120	1,144	205,920
Univ. "A. Moisiu" Durrës (Filiali Peshkopi)	84	Financë-Kontabilitet	780	140,400	1,144	205,920
Universiteti i Sporteve të Tiranës	85	Shkencat e Lëvizjes	954	171,662	1,144	205,920

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 5.12.2011
Doli nga shtypi më 7.12.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2011

Çmimi 56 lekë